



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.135

3 tetor

2011

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.10 460 datë 13.9.2011	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Francës për shkëmbimin dhe mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar”.....	6083
Ligj nr.10 461 datë 13.9.2011	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10 173, datë 22.10.2009 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë”.....	6090
Ligj nr.10 462 datë 13.9.2011	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9718, datë 19.4.2007 “Për Urdhrin e Infermierit në Republikën e Shqipërisë”.....	6091
Vendim i Kuvendit nr.122, datë 13.9.2011	Për zgjedhjen e një anëtari të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.....	6092
Vendim i Kuvendit nr.123, datë 13.9.2011	Për zgjedhjen e një anëtari të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.....	6093
Vendim i Kuvendit nr.124, datë 13.9.2011	Për zgjedhjen e anëtarit të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në pozicionin nënkryetar, Drejtues i Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit.....	6093
Vendim i Kuvendit nr.125, datë 13.9.2011	Për zgjedhjen e anëtarit të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në pozicionin nënkryetar, drejtues i Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit.....	6094
Vendim i KM nr.653, datë 14.9.2011	Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes të Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për Universitetin e Tiranës, të pronës nr.8, me emërtim “Qendra e Mobilizimit”, me vendndodhje në rrugën “Todi Shkurti”, Tiranë, dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme	

	shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar.....	6094
Vendim i KM nr.657, datë 28.9.2011	Për ndryshimin e emërimit, nga shkolla e lartë universitare, jopublike, “Universiteti European i Tiranës”, në Universiteti European i Tiranës.....	6095
Vendim i GJK nr.37, datë 19.9.2011	Me objekt: 1. Shfuqizimin, pjesërisht si të papajtueshëm me Kushtetutën, të nenit 435/2 të Kodit të Procedurës Penale, dhe konkretisht shprehjes: “akti i rekursit dhe memoriet duhet të nënshkruhen, me pasojë mospranimi, nga mbrojtësit”; 2. Shfuqizimin, pjesërisht si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimit të Kolegjeve të Bashkuara nr.5, datë 15.9.2009, dhe konkretisht të shprehjes: “Rekursi penal të nënshkruhet nga mbrojtësi, në të kundërt ai nuk pranohet për shqyrtim në Gjykatën e Lartë”; 3. Shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimeve nr.355, datë 12.3.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr.40, datë 23.1.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr.00-2009-313 (607), datë 6.11.2009 të Gjykatës së Lartë.....	6095
Vendim i GJK nr.38, datë 20.9.2011	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.532, datë 27.4.2006 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.	6100
Vendim i GJK nr.39, datë 21.9.2011	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr.505, datë 14.10.2009 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.....	6103
Vendim i GJK nr.40, datë 22.9.2011	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimeve: nr.101, datë 7.4.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; nr.117, datë 26.10.2007 të Gjykatës së Apelit Korçë; nr.184, datë 3.3.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.....	6105

LIGJ
Nr.10 460, datë 13.9.2011

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË FRANCËS, PËR SHKËMBIMIN DHE MBROJTJEN E NDËRSJELLË TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVEND I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Francës për shkëmbimin dhe mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.7086, datë 27.9.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË FRANCËS, NË LIDHJE ME SHKËMBIMIN DHE MBROJTJEN RECIPROKE TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, Qeveria e Republikës Franceze, këtu të quajtura “palët”,

me dëshirën për të siguruar mbrojtjen e informacionit dhe materialeve të klasifikuara të shkëmbyera ose të prodhuara ndërmjet dy shteteve ose ndërmjet institucioneve publike ose private, të cilat u nënshtrohen ligjeve dhe rregullave të tyre kombëtare përkatëse, kanë rënë dakord për përcaktimet e mëposhtme.

Neni 1
Përkufizime

Për qëllimet e kësaj marrëveshjeje:

1.1 “Informacion i klasifikuar” është informacioni, dokumentet dhe materialet, pavarësisht nga forma, natyra ose mënyra e transmetimit të tyre, të përgatitura ose që përgatiten, për të cilat është caktuar një shkallë klasifikimi ose nivel sensitiviteti dhe që, në interes të sigurisë kombëtare dhe në pajtim me ligjet dhe rregulloret kombëtare të palëve, kërkojnë mbrojtjen ndaj çdo shkeljeje, shkatërrimi, përvetësimi, përhapjeje, humbjeje ose aksesit nga ndonjë individ i paautorizuar ose një lloj tjetër kompromentimi.

1.2 “Autoritet i sigurisë kombëtare” (ASK) është autoriteti i brendshëm, përgjegjës për kontrollin e përgjithshëm dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje për secilën prej palëve.

1.3 “Autoritete kompetente të sigurisë” (AKS) është çdo autoritet i emëruar për sigurinë (AES) ose çdo autoritet tjetër kompetent i autorizuar në pajtim me ligjet dhe rregulloret kombëtare të palëve që është përgjegjës për zbatimin e kësaj marrëveshjeje sipas fushave përkatëse.

1.4 “Kontratë e klasifikuar” është një kontratë, një nënkontratë ose projekt, përgatitja ose zbatimi i së cilës/të cilit kërkon akses në informacionin e klasifikuar ose përdorimin dhe prodhimin e informacionit të klasifikuar.

1.5 “Palë kontraktuese” është çdo individ ose subjekt juridik që ka zotësinë ligjore për të negociuar dhe lidhur kontrata të klasifikuara.

1.6 “Pala e origjinës” është pala, duke përfshirë çdo institucion publik ose privat, e cila u nënshtrohet ligjeve dhe rregullave të saj kombëtare, që lëshon ose jep informacion të klasifikuar për palën tjetër.

1.7 “Pala marrëse” është pala, duke përfshirë çdo institucion publik ose privat, e cila u nënshtrohet ligjeve dhe rregullave të saj kombëtare të cilit/të cilës i transmetohet informacion i klasifikuar.

1.8 “Pala e tretë” është çdo shtet, duke përfshirë subjektet juridike ose individët nën juridiksionin e tij ose organizatë ndërkombëtare që nuk është palë në këtë marrëveshje.

1.9 “Pala pritëse” është pala në territorin e së cilës zhvillohet një vizitë.

1.10 “Nevojë për njohje” është nevoja për të pasur akses në informacionin e klasifikuar në kuadrin e një pozicioni të caktuar zyrtar dhe me qëllim përmbushjen e një detyre specifike.

Neni 2

Fusha e zbatimit

Kjo marrëveshje përcakton rregullat e përgjithshëm të sigurisë që zbatohen për çdo shkëmbim të informacionit të klasifikuar ndërmjet palëve ose ndërmjet institucioneve të tyre publike ose private, të cilat u nënshtrohen ligjeve dhe rregullave të tyre kombëtare.

Neni 3

Autoritetet e sigurisë kombëtare

Autoriteti i sigurisë kombëtare për secilën palë është:

Për Republikën e Shqipërisë:

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të klasifikuar (DSIK)

Këshilli i Ministrave

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”,

Tiranë

Për Republikën Franceze:

Secrétariat Général de la Défense et de la Sécurité Nationale (SGDSN)

51, boulevard de la Toyr-Maubourg

75700 Paris 07 SP

Palët informojnë njëra-tjetrën për çdo ndryshim në lidhje me autoritetin e tyre të sigurisë kombëtare, si dhe autoritetet e tyre kompetente të sigurisë.

Neni 4

Parimet e sigurisë

4.1 Në pajtim me ligjet dhe rregulloret e tyre kombëtare përkatëse, palët marrin masat përkatëse për të mbrojtur informacionin e klasifikuar të transmetuar, marrë ose krijuar në bazë të 6084

përcaktimeve të kësaj marrëveshjeje dhe i jep atij informacioni një nivel mbrojtjeje të barasvlefshëm me atë që i është dhënë informacionit të klasifikuar të vet të brendshëm, sipas përcaktimit në nenin 5, paragrafi 5.1,

4.2 Pala marrëse i vendos informacionit të klasifikuar të marrë nga pala e origjinës klasifikimin e vet të brendshëm, në pajtim me barasvlefshmërinë e përcaktuar në nenin 5, paragrafi 5.1.

4.3 Aksesi në informacionin e klasifikuar u rezervohet rigorozisht qytetarëve të palëve që janë pajisur me certifikatë të përshtatshme dhe detyrat e të cilëve e kanë të rëndësishme aksesin në atë informacion mbi bazën e nevojës për njohje.

4.4 Pala marrëse nuk e ul nivelin apo deklasifikon informacionin e klasifikuar të transmetuar pa pëlqimin paraprak me shkrim të palës së origjinës.

4.5 Palët informojnë menjëherë njëra-tjetrën për çdo ndryshim që ndikon në mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, të shkëmbyer ose të prodhuar në bazë të kësaj marrëveshjeje.

4.6 Informacioni i klasifikuar i transmetuar nuk mund të përdoret për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat është transmetuar.

4.7 Palët sigurojnë që të respektohet çdo kërkesë që lind nga ligjet dhe rregulloret e tyre kombëtare të sigurisë në lidhje me sigurinë e agjencive, zyrave dhe strukturave nën juridiksionin e tyre, në veçanti nëpërmjet inspektimeve.

Neni 5

Klasifikimet dhe barasvlefshmëria e sigurisë

5.1 Palët marrin përsipër të mbrojnë informacionin e klasifikuar të shkëmbyer dhe miratojnë barasvlefshmërinë e niveleve të klasifikimit të sigurisë së përcaktuar në tabelën e mëposhtme.

Shqipëri	Francë
Tepër sekret	Tres secret defense
Sekret	Secret defense
Konfidencial	Confidentiel defense
I kufizuar	(Shih paragrafët 5.2 dhe 5.3 më poshtë)

5.2 Republika Franceze përpunon dhe mbron informacionin e shënuar “i kufizuar” të transmetuar nga Republika e Shqipërisë në pajtim me ligjet dhe rregulloret e saj kombëtare në fuqi në lidhje me informacionin e mbrojtur, por të paklasifikuar si “diffusion restreinte”.

5.3 Republika e Shqipërisë përpunon dhe mbron informacionin e paklasifikuar, por të shënuar si të mbrojtur si “diffusion restreinte” të transmetuar nga Republika Franceze në pajtim me ligjet dhe rregulloret e saj kombëtare në fuqi në lidhje me mbrojtjen e informacionit “i kufizuar”.

5.4 ASK-të ose AKS-të informojnë njëra-tjetrën për çdo klasifikim të ri sigurie ose ndryshim klasifikimi lidhur me informacionin që mund të shkëmbehet ose prodhohet në bazë të kësaj marrëveshjeje.

5.5 Për shkaqe të sigurisë specifike, nëse pala e origjinës kërkon që aksesi në informacionin e klasifikuar të kufizohet për personat që kanë ekskluzivisht shtetësinë e palëve, ky informacion do të mbajë shënimin shtesë “Special Francë-Albania”.

5.6 Me qëllim që të ruhen standardet e barasvlerëshme të sigurisë, me kërkesë të njëjës prej palëve, secila palë jep të gjithë informacionin e kërkuar në lidhje me ligjet, rregulloret dhe procedurat kombëtare të sigurisë që zbatohen për të siguruar sigurinë e informacionit të klasifikuar. Secila palë bie dakord të lehtësojë kontaktet ndërmjet ASK-ve dhe AKS-ve të tyre përkatëse.

Neni 6

Procedura e certifikimit të sigurisë

6.1 Për akses në informacionin e klasifikuar “konfidencial/confidentiel defense” ose në një nivel më të lartë, secila palë zbaton një procedurë të certifikimit të sigurisë në pajtim me ligjet dhe rregulloret e saj kombëtare.

6.2 Për certifikatën e sigurisë së një qytetari të një prej palëve që ka qëndruar ose që vazhdon të jetë në territorin e palës tjetër, ASK-ja ose AKS-ja e secilës prej palëve ndihmojnë njëra-tjetrën në pajtim me ligjet dhe rregulloret e saj kombëtare.

6.3 Palët njohin reciprokisht certifikatat e sigurisë të lëshuara për qytetarët e tyre në kuadër të aksesit në informacionin e klasifikuar.

6.4 Nëse ASK-ja ose AKS-ja e një prej palëve është e mendimit që një shoqëri e regjistruar në territorin e saj kombëtar është në pronësi ose kontrollon nga një shtet i tretë, qëllimet e të cilit nuk janë në pajtueshmëri me interesat e saj, asaj shoqërie nuk i lëshohet certifikatë sigurie. Për rrjedhojë, ASK-të ose AKS-të e palëve që kanë kërkuar certifikatë sigurie për një strukturë njoftohen sa më shpejt të jetë e mundur.

6.5 ASK-të ose AKS-të njoftojnë njëra-tjetrën për ndryshimet që ndikojnë mbi certifikatat e sigurisë së qytetarëve të tyre, në bazë të kësaj marrëveshjeje, veçanërisht, në rastin e tërheqjes së certifikatës ose uljes së nivelit të saj.

Neni 7

Përdorimi i informacionit të klasifikuar

7.1 Pala marrëse nuk mund të përhapë informacionin e klasifikuar të shkëmbyer ose të përgatitur sipas kësaj marrëveshjeje një pale të tretë, pa pëlqimin paraprak me shkrim të ASK-së ose AKS-së së palës së origjinës.

7.2 Informacioni i klasifikuar, i përgatitur së bashku nga palët sipas marrëveshjeve, kontratave ose në kuadër të një aktiviteti të përbashkët nuk mund të ulet në nivel sigurie, deklasifikohet ose t’i dërgohet një pale të tretë pa pëlqimin paraprak me shkrim të palës tjetër.

7.3 Para transmetimit të një informacioni të klasifikuar të marrë nga pala e origjinës tek palët kontraktuese, ASK-ja ose AKS-të e palës marrëse duhet:

a) të sigurojnë që palët kontraktuese dhe strukturat e tyre janë në gjendje të japin mbrojtje të përshtatshme për informacionin e klasifikuar;

b) të japin nivelin e përshtatshëm të certifikimit për strukturat e palëve përkatëse kontraktuese;

c) të japin nivelin e përshtatshëm të certifikatës për individët në pajtim me parimin “Nevojë për njohje”;

d) të sigurojnë që të gjithë individët që kanë akses në informacionin e klasifikuar janë instruktuar në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e tyre që rrjedhin nga ligjet dhe rregulloret e zbatueshme kombëtare;

e) të kryejnë kontrollet e sigurisë së strukturave përkatëse.

Neni 8

Përkthimi, riprodhimi dhe shkatërrimi

8.1 Pala marrëse i shënon riprodhimet dhe përkthimet e bëra si origjinalet dhe u jep atyre të njëjtën mbrojtje.

8.2 Informacioni i klasifikuar “tepër sekret/tres secret defense” as nuk riprodhohet, as nuk përkthehet. Dokumente origjinale dhe përkthime shtesë mund të jepen pas kërkesës me shkrim drejtuar palës së origjinës.

8.3 Informacioni i klasifikuar “tepër sekret/sekret secret defense” nuk duhet të shkatërrohet, përveç kur shkatërrimi është i autorizuar shprehimisht nga pala e origjinës. Ai i kthehet palës së origjinës në pajtim me paragrafët 9.1 ose 9.2 më poshtë, pasi të jetë njohur më tej i panevojshëm ose me skadimin e vlefshmërisë së tij.

8.4 Përkthimi dhe riprodhimi i informacionit të klasifikuar “sekret/secret defense” autorizohet vetëm me pëlqimin me shkrim të ASK-së ose AKS-së të palës së origjinës.

8.5 Informacioni i klasifikuar shkatërrohet në mënyrë të tillë që të jetë e pamundur për ta rindërtuar atë plotësisht ose pjesërisht.

8.6 Në situata krizash, kur bëhet e pamundur të mbrohet dhe kthehet informacioni i klasifikuar i gjeneruar ose i dhënë në pajtim me këtë marrëveshje, informacioni i klasifikuar shkatërrohet menjëherë. ASK-ja e palës marrëse njofton ASK-në e palës së origjinës në lidhje me shkatërrimin e informacionit të klasifikuar sa më shpejt të jetë e mundur.

Neni 9

Transmetimi i informacionit ndërmjet palëve

9.1 Informacioni i klasifikuar dërgohet nga njëra palë tek tjetra nëpërmjet kanaleve diplomatike në pajtim me ligjet dhe rregulloret kombëtare të palës së origjinës.

9.2 ASK-ja ose AKS-të, me marrëveshje të përbashkët, mund të bien dakord që informacioni i klasifikuar mund të dërgohet me mjete të ndryshme nga ato të kanaleve diplomatike nëse kjo metodë transmetimi duket e papërshtatshme ose e vështirë.

9.3 Transmetimi duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme:

a) Korrieri ka certifikatë të përshtatshme sigurie. Korrieri është një punonjës i përhershëm i shoqërisë dërguese ose marrëse, ose i përket administratës dhe ka një certifikatë sigurie të paktën të nivelit të informacionit të klasifikuar që transmetohet;

b) Korrieri ka një certifikatë korrieri të dhënë nga ASK-ja ose AKS-ja e dërguesit ose e marrësit;

c) Pala e origjinës mban një regjistër të informacionit të klasifikuar të transmetuar dhe një ekstrakt nga regjistri i jepet palës marrëse me kërkesë;

d) Informacioni i klasifikuar paketohet dhe vulozet në pajtim me ligjet dhe rregulloret kombëtare të palës së origjinës;

e) Marrja e informacionit të klasifikuar konfirmohet me shkrim sa më shpejt që të jetë e mundur.

9.4 Transmetimi i një sasive të konsiderueshme informacioni të klasifikuar organizohet ndërmjet ASK-ve dhe AKS-ve rast pas rasti.

9.5 Informacioni i klasifikuar transmetohet elektronikisht në formë të kriptuar, duke përdorur metodat dhe mjetet kriptografike të pranuar bashkërisht nga ASK-të ose AKS-të përkatëse.

Neni 10

Kontratat e klasifikuara

10.1 ASK-ja ose AKS-ja e palës së origjinës njoftojnë ASK-në ose AKS-në e palës marrëse për çdo kontratë të klasifikuar para shkëmbimit të informacionit të klasifikuar. Ky njoftim mund të specifikojë nivelin më të lartë të klasifikimit të informacionit të përfshirë në kontratë.

10.2 Pala që ka ndërmend të lidhë ose të autorizojë një prej palëve të saj kontraktuese, të lidhë një kontratë të klasifikuar me një palë kontraktuese të palës tjetër, kontrollon nëpërmjet ASK-së ose AKS-së së kësaj pale që kjo palë kontraktuese ka nivelin e përshtatshëm të certifikatës për të përmbushur kontratën. Në mungesë të një certifikate të tillë, ASK-ja ose AKS-ja e palës marrëse fillojnë një procedurë certifikimi në nivelin e përshtatshëm.

10.3 Para lidhjes së një kontrate të klasifikuar me një palë kontraktuese e cila ndodhet në juridiksionin e palës tjetër, apo autorizimit të një prej palëve të veta kontraktuese për të lidhur një kontratë të klasifikuar në territorin e palës tjetër, një pale i jepet së pari garanci me shkrim nga AKS-ja ose ASK-ja e palës tjetër që, palës kontraktuese të propozuar i është dhënë një nivel certifikate i përshtatshëm dhe që ajo ka marrë të gjitha masat e përshtatshme të sigurisë që kërkohen për të mbrojtur informacionin e klasifikuar.

10.4 Për një kontratë të klasifikuar, hartohet një shtojcë sigurie. Në këtë shtojcë, ASK-ja ose AKS-ja e palës së origjinës specifikojnë se çfarë duhet të mbrohet nga pala marrëse, si dhe nivelin përkatës të zbatueshëm të klasifikimit. Vetëm pala e origjinës mund të modifikojë nivelin e klasifikimit të informacionit të përcaktuar në shtojcën e sigurisë.

10.5 Të gjitha kontratat e klasifikuara përmbajnë informacion në lidhje me udhëzimet e sigurisë, si dhe një udhëzim klasifikimi. Këto udhëzime janë në pajtim me ato të dhëna nga ASK-ja ose AKS-ja e palës së origjinës.

10.6 ASK-ja ose AKS-ja e palës së origjinës i dërgojnë një kopje shtojcës së sigurisë AKS-së ose ASK-së së palës tjetër.

10.7 ASK-ja ose AKS-ja e palëve, në territorin e të cilave duhet të kryhet puna, duhet të sigurojë, në kuadrin e përmbushjes së kontratave të klasifikuara, që të zbatohet dhe ruhet një nivel sigurie, të barasvlershëm me atë të kërkuar për të mbrojtur kontratat e tyre të klasifikuara.

10.8 Para nënshkrimit të një kontrate të klasifikuar me një palë nënkontraktuese, pala kontraktuese autorizohet nga ASK-ja ose AKS-të e veta. Palët nënkontraktuese respektojnë të njëjtat kushte sigurie si ato të hartuara për palën kontraktuese.

Neni 11 Vizitat

11.1 Vizitat në ambientet e një prej palëve ku një përfaqësues i palës tjetër ka akses në informacionin e klasifikuar ose në vendet ku aksesin në këtë informacion është drejtpërdrejtë i mundur i nënshtrohet autorizimit paraprak me shkrim nga ASK-ja ose AKS-ja e palës pritëse.

11.2 Vizitat tek ambientet e një pale nga një palë e tretë që mundësojnë akses në informacionin e klasifikuar të shkëmbyer ose të prodhuar ndërmjet palëve ose në vendet ku aksesin në këtë informacion është drejtpërdrejtë i mundur i nënshtrohet autorizimit paraprak me shkrim nga ASK-ja ose AKS-ja e palës tjetër.

11.3 Vizitat e përmendura në paragrafin 11.1 dhe 11.2 më sipër kërkojnë që të gjithë vizitorët të kenë certifikatë të përshtatshme sigurie dhe nevojë për njohje.

11.4 Kërkesat për vizita kur kërkohet akses për informacionin e klasifikuar të nivelit “tepër sekret/tres secret defense” dërgohen nëpërmjet kanaleve diplomatike tek ASK-ja e palës pritëse. Kërkesat për vizita kur kërkohet aksesin në informacionin e klasifikuar i një niveli më të ulët, përpunohen drejtpërdrejt ndërmjet ASK-ve ose AKS-ve përkatëse. Kërkesat dërgohen të paktën tre (3) javë para datës së kërkuar për vizitën.

11.5 Kërkesa për vizitë duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

a) Emrin dhe mbiemrin e vizitorit, datën dhe vendin e lindjes, shtetësinë dhe numrin e pasaportës ose të kartës së identitetit;

b) Punën dhe pozicionin e vizitorit, emrin e strukturës ose institucionit që ka punësuar atë;

c) Nivelin e certifikatës së sigurisë së vizitorit, të vërtetuar nga një certifikatë sigurie që jepet nga ASK-ja ose AKS-ja e palës kërkuese;

d) Datën e propozuar të vizitës dhe kohëzgjatja e planifikuar;

e) Qëllimin e vizitës dhe të gjithë informacionin e nevojshëm që specifikon subjektet që do të trajtohen, të cilat prekin informacion të klasifikuar dhe nivelet e tij të sigurisë;

f) Emrat e strukturave, ambienteve dhe vendeve që preken nga vizita;

g) Mbiemrat dhe emrat e individëve që duhet të presin vizitorin;

h) Datën, nënshkrimin dhe vulën zyrtare të ASK-së ose AKS-ve të palës kërkuese.

11.6 Secila palë mund të kërkojë një autorizim për një vizitë për një periudhë maksimale prej dymbëdhjetë (12) muajsh. Nëse një vizitë e caktuar nuk mund të bëhet brenda afatit kohor të parashikuar në autorizim për një vizitë ose nëse kërkohet një shtyrje e periudhës së parashikuar në autorizim për një vizitë. Pala kërkuese mund të kërkojë një autorizim të ri për një vizitë, parashikuar që ajo të bëhet të paktën tre (3) javë para skadimit të autorizimit të tanishëm.

11.7 Të gjithë vizitorët respektojnë rregulloret e sigurisë dhe udhëzimet e palës pritëse.

11.8 Palët mund të përpilojnë një listë të personelit të autorizuar për të kryer disa vizita në lidhje me një projekt, program ose kontratë specifike në pajtim me modalitete standarde të rëna dakord nga ASK-ja ose AKS-ja e palëve. Së pari, këto lista janë të vlefshme për një periudhë prej dymbëdhjetë (12) muajsh dhe me marrëveshje ndërmjet ASK-së ose AKS-së së palëve, kjo periudhë vlefshmërie mund të shtyhet për periudha të tjera që nuk kalojnë në total dymbëdhjetë (12) muaj.

11.9 Listat e përmendura në paragrafin 11.8 të mësipërm hartohen në pajtim me ligjet dhe rregulloret kombëtare të palës pritëse. Sapo këto lista të jenë aprovuar, modalitetet standarde të çdo vizite specifike mund të përpilohen drejtpërdrejt nga strukturat që do të vizitojnë personat e përmendur në këto lista.

Neni 12

Shkeljet e sigurisë

12.1 Në rastin e një shkeljeje të rregulloreve kombëtare në lidhje me mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, të transmetuar sipas kësaj marrëveshjeje, ose në rastet kur nuk mund të përjashtohet, prezumohet ose zbulohet, veçanërisht në rastin e humbjes ose të një lloji tjetër komprometimi të pandershëm të dyshuar ose të provuar. ASK-ja ose AKS-ja e palës tjetër njoftohen menjëherë me shkrim.

12.2 Njoftimi duhet të përmbajë detaje të mjaftueshme në mënyrë që pala e origjinës të mund të vlerësojë plotësisht pasojat.

12.3 Pala që ka zbuluar ose dyshuar faktet kryen menjëherë një hetim (me ndihmën e palës tjetër, nëse është e nevojshme) në pajtim me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme kombëtare të shtetit përkatës. Pala që kryen hetimin informon ASK-në ose AKS-në e palës tjetër për konstatimet e hetimit, masat e vendosura dhe veprimet korrigjuese të marra sa më shpejt të jetë e mundur.

Neni 13

Shpenzimet

13.1 Në parim, përmbushja e kësaj marrëveshjeje nuk gjeneron ndonjë kosto të veçantë.

13.2 Të gjitha shpenzimet e shkaktuara nga një palë për llogari të zbatimit të kësaj marrëveshjeje mbulohen vetëm nga kjo palë.

Neni 14

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

14.1 Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje zgjidhet ekskluzivisht me konsultime ndërmjet palëve, pa thirrur asnjë palë të tretë apo gjykatë ndërkombëtare.

14.2 Gjatë shqyrtimit të mosmarrëveshjes, palët marrin përsipër të respektojnë detyrimet e parashikuara në këtë marrëveshje.

Neni 15

Dispozita të fundit

15.1 Kjo marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar. Secila prej palëve njofton palën tjetër për përfundimin e procedurave të brendshme në lidhje me hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje. Ajo hyn në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë pas marrjes së njoftimit të fundit.

15.2 ASK-ja ose AKS-të e palëve zhvillojnë konsultime për aspekte specifike teknike në lidhje me zbatimin e kësaj marrëveshjeje dhe mund të përfundojnë çdo instrument të përshtatshëm ligjor ose protokoll të veçantë sigurie për të plotësuar këtë marrëveshje rast pas rasti.

15.3 Secila palë njofton menjëherë palën tjetër për çdo ndryshim në ligjet dhe rregulloret e veta kombëtare që mund të kenë efekt mbi mbrojtjen e informacionit të klasifikuar sipas kësaj marrëveshjeje. Në këtë rast, palët zhvillojnë konsultime me qëllim që të shqyrtojnë çdo ndryshim të

mundshëm në këtë marrëveshje. Ndërkohë informacioni i klasifikuar vazhdon të mbrohet në pajtim me këto dispozita.

15.4 Dispozitat e kësaj marrëveshjeje mund të ndryshohen me marrëveshje të përbashkëta me shkrim nga palët. Këto ndryshime mund të hyjnë në fuqi në pajtim me modalitetet e parashikuara në paragrafin 15.1.

15.5 Kjo marrëveshje mund të zgjidhet me marrëveshje të përbashkët ose në mënyrë të njëanshme. Njoftimi i zgjidhjes hyn në fuqi gjashtë (6) muaj pas marrjes së njoftimit me shkrim. Njoftimi i zgjidhjes nuk ka ndikim mbi të drejtat dhe detyrimet e palëve në lidhje me informacionin e shkëmbyer në bazë të kësaj marrëveshjeje.

Në dëshmi të kësaj, përfaqësuesit e të dyja palëve, duke qenë rregullisht të autorizuar për këtë qëllim, kanë nënshkruar këtë marrëveshje dhe e kanë vulosur atë.

Nënshkruar në Tiranë, më 3 maj 2011, në dy kopje në gjuhët shqipe dhe frënge, ku të dyja versionet janë autentike.

LIGJ

Nr.10 461, datë 13.9.2011

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.10 173, DATË 22.10.2009 “PËR MBROJTJEN E DËSHMITARËVE DHE TË BASHKËPUNËTORËVE TË DREJTËSISË”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.10 173, datë 22.10.2009 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 9, pas pikës 6 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. Kryetari dhe anëtarët e komisionit marrin shpërblim financiar në masën dhe mënyrën e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 2

Në nenin 28 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Vendim i Këshillit të Ministrave për shpërblimin financiar të kryetarit dhe anëtarëve të komisionit, në zbatim të pikës 7 të nenit 9 të këtij ligji.”.

2. Në pikën 2, fjalia e parë riformulohet si më poshtë:

“2. Udhëzim i përbashkët i Ministrit të Brendshëm, Ministrit të Drejtësisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm për:”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.7087, datë 27.9.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

LIGJ
Nr.10 462, datë 13.9.2011

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9718, DATË 19.4.2007
“PËR URDHRIN E INFERMIERIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9718, datë 19.4.2007 “Për Urdhrin e Infermierit në Republikën e Shqipërisë”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 1, pas fjalës “fizioterapeft” shtohen fjalët “teknik/e laboratorit, teknik/e imazherie, logopedist/e”.

Neni 2

Neni 2 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 2

Ky ligj e shtrin veprimtarinë e vet në të gjithë territorin e vendit dhe zbatohet për të gjithë infermierët/et, mamitë, fizioterapeftët/et, teknikët/et e laboratorit, teknikët/et e imazherisë dhe logopedistët/et, që ushtrojnë profesionin në Republikën e Shqipërisë.”.

Neni 3

Neni 3 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 3

Urdhri i Infermierit është ent publik jobuxhetor, i cili përfaqëson interesat e përbashkët të profesioneve të infermierit/es, mamisë, fizioterapeftit/es, teknikut/es të/së laboratorit, teknikut/es të/së imazherisë dhe logopedistit/es, si dhe rregullon marrëdhëniet ndërmjet tyre, në funksion të publikut.”.

Neni 4

Në nenin 4 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikat 1, 2, 3 dhe 4, pas fjalëve “infirmierët dhe mamitë” shtohen fjalët “fizioterapeft/e, teknik/e laborator, teknik/e imazherie dhe logopedist/e”.

2. Në pikën 5 dhe në të gjitha nenet e tjera të ligjit fjalët “mami, infirmier ose fizioterapeft” zëvendësohen me fjalët “infirmier/e, mami, fizioterapeft/e, teknik/e laborator, teknik/e imazherie dhe logopedist/e”.

Neni 5

Në nenin 12 pika 1 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Fjalët “17 anëtarë” zëvendësohen me fjalët “21 anëtarë”.

2. Pas shkronjës “dh” shtohen shkronjat “e”, “ë” dhe “f” me këtë përmbajtje:

“e) dy përfaqësues të shoqatës së pacientëve;

ë) një përfaqësues i sindikatës së infirmierëve;

f) Zëvendës-presidenti i Urdhrit të Infirmierit të Tiranës.”.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.7088, datë 27.9.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

VENDIM

Nr.122, datë 13.9.2011

PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË BORDIT TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 6 të ligjit nr.9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Astrit Hado zgjidhet anëtar i Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)**

VENDIM
Nr.123, datë 13.9.2011

**PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË BORDIT TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES
FINANCIARE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 6 të ligjit nr.9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zonja Kestrin Katro zgjidhet anëtare e Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.124, datë 13.9.2011

**PËR ZGJEDHJEN E ANËTARIT TË BORDIT TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES
FINANCIARE NË POZICIONIN NËNKRYETAR, DREJTUES I DEPARTAMENTIT TË
LICENCIMIT DHE MONITORIMIT**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 6 të ligjit nr.9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zonja Enkela Idrizi zgjidhet anëtare e Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në pozicionin Nënkyetar, drejtues i Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.125, datë 13.9.2011

**PËR ZGJEDHJEN E ANËTARIT TË BORDIT TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES
FINANCIARE NË POZICIONIN NËNKRYETAR, DREJTUES I DEPARTAMENTIT TË
MBIKËQYRJES DHE DISIPLINIMIT**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 6 të ligjit nr.9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zonja Enkeleda Shehi zgjidhet anëtare e Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në pozicionin Nënkyetar, drejtues i Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.653, datë 14.9.2011

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS, PËR UNIVERSITETIN E TIRANËS, TË
PRONËS NR.8, ME EMËRTIM “QENDRA E MOBILIZIMIT”, ME VENDNDODHJE NË
RRUGËN “TODI SHKURTI”, TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS
SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT
I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për Universitetin e Tiranës, të pronës nr.8, me emërtim “Qendra e mobilizimit”, me vendndodhje në rrugën “Todi Shkurti”, Tiranë, për vendosjen në këto mjedise të Muzeut të Shkencave të Natyrës, të këtij universiteti, për sigurimin e zhvillimit normal të mësimin dhe kërkimit të zhvillimit akademik e shkencor.
2. Prona nr.8, me emërtim “Qendra e mobilizimit”, me vendndodhje në rrugën “Todi Shkurti”, Tiranë, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.
3. Dorëzimi i pronës të bëhet pas transferimit të Qendrës së Mobilizimit, Tiranë, dhe pas heqjes së materialeve e të pajisjeve të Forcave të Armatosura, të magazinuara në këtë pronë.

4. Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Universitetit të Tiranës u ndalohe të ndryshojnë destinacionin e pronës, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojnë ose t'ia japin në përdorim të tretëve.

5. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.657, datë 28.9.2011

PËR NDRYSHIMIN E EMËRTIMIT, NGA SHKOLLA E LARTË UNIVERSITARE, JOPUBLIKE, “UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS”, NË UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, 5, 40, 43 e 44 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Emërtimi: Shkolla e lartë universitare, jopublike, “Universiteti European i Tiranës”, ndryshohet dhe zëvendësohet me: Universiteti European i Tiranës.

2. Ky institucion i arsimit të lartë privat ruan akreditimin institucional dhe të programeve të studimit të fituar para hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion.

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti European i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.37, datë 19.9.2011

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Vladimir Kristo	Anëtar	i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“	“
Petrit Pllloçi	Anëtar	i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare	e	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar	i	“	“
Sokol Berberi	Anëtar	i	“	“
Admir Thanza	Anëtar	i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare	e	“	“

me sekretare Blerina Çinari, në datën 31.5.2011, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.19 akti, që i përket:

KËRKUES: Bardhyl Ibra

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme, në mungesë.

OBJEKTI: 1. Shfuqizimi, pjesërisht si i papajtueshëm me Kushtetutën i nenit 435/2 të Kodit të Procedurës Penale, dhe konkretisht shprehjes: “akti i rekursit dhe memoriet duhet të nënshkruhen, me pasojë mospranimi, nga mbrojtësit”; 2. Shfuqizimi, pjesërisht si i papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimit të Kolegjeve të Bashkuara nr.5, datë 15.9.2009, dhe konkretisht i shprehjes: “Rekursi penal të nënshkruhet nga mbrojtësi, në të kundërt ai nuk pranohet për shqyrtim në Gjykatën e Lartë”; 3. Shfuqizimi, si të papajtueshëm me Kushtetutën i vendimeve nr.355, datë 12.3.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr.40, datë 23.1.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr.00-2009-313 (607), datë 6.11.2009 të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f, dhe 134/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, Bashkim Dedja, kërkuesin që u shpreh për pranimin e kërkesës; përfaqësuesin e subjektit të interesuar që në prapësimet me shkrim ka kërkuar rrëzimin e kërkesës dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Me vendimin nr.355, datë 12.3.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kërkuesi është deklaruar fajtor për veprën penale të “falsifikimit të dokumenteve shkollore”, parashikuar nga neni 187/1 të Kodit Penal dhe në bazë të këtij neni dhe nenit 34 të Kodit Penal, është dënuar me 100.000 lekë gjobë. Me vendimin nr.40, datë 23.1.2008, Gjykata e Apelit të Tiranës ka lënë në fuqi vendimin nr.355, datë 12.3.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

2. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me recurs. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.00-2009-313(607), datë 6.11.2009 ka vendosur: “Mospranimin e rekursit” me arsyetimin se: “Rekursi i paraqitur nga i gjykuari, Bardhyl Ibra, nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 435/1 i KPP-së”.

3. Kërkuesi, në datën 25.1.2011, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke kërkuar shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën, në nenin 435/2 të Kodit të Procedurës Penale, (KPP) të shprehjes: “Akti i rekursit dhe memoriet duhet të nënshkruhen, me pasojë mospranimi nga mbrojtësit”; shfuqizimin e vendimit të Kolegjeve të Bashkuara nr.5, datë 15.9.2009 të shprehjes: “Rekursi penal të nënshkruhet nga mbrojtësi, në të kundërt ai nuk pranohet për shqyrtim në Gjykatën e Lartë”; shfuqizimin e vendimeve nr.355, datë 12.3.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr.40, datë 23.1.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr.607, datë 6.11.2009 të Gjykatës së Lartë.

4. **Kërkuesi** ka kërkuar pranimin e kërkesës, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur këto shkaqe:

4.1 Togfjalëshi “*të nënshkruhen nga mbrojtësit*” në nenin 435/2 të KPP-së, dhe përforcuar si kriter edhe me vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë nr.5, datë 15.9.2009, përbën një kufizim, i cili cenon thelbin e të drejtës për t’u ankuar dhe si i tillë, duhet shfuqizuar si antikushtetues.

4.2 Prokuroria gjatë fazës së hetimeve, si dhe gjykatat nuk kanë pranuar kërkesat për marrje të provave si thirrje dëshmitarësh dhe kryerje aktesh ekspertimi, si dhe nuk i kanë vlerësuar si duhet provat e marra.

4.3 Nuk i është dhënë e drejta e mbrojtjes me avokat bazuar në nenin 31/ç dhe nenin 42 të Kushtetutës.

4.4 Gjykatat nuk i kanë arsyetuar vendimet gjyqësore konform nenit 142/1 dhe 42 të Kushtetutës.

4.5 Gjykata e Lartë i ka mohuar të drejtën për akses në gjykatë, për shkak mospranimi të rekursit të panënskruar nga mbrojtësi, por vetëm prej tij.

5. *Subjekti i interesuar, Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm* ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, me këto prapësime:

5.1 Kërkuesi nuk legjitimohet për një pjesë të kërkesës ku kërkon shfuqizim pjesërisht të nenit 435/2 të KPP-së, si dhe shfuqizim pjesërisht të vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara nr.5, datë 15.09.2009.

5.2 Kërkuesi nuk ka shteruar të gjitha mjetet në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, për pretendimet e tij për proces të parregullt ligjor.

5.3 Vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nuk është mbështetur te fakti i mosnënskruarimit të kërkesës nga mbrojtësi, por te mungesa e shkaqeve ligjore për pranimit rekursi.

5.4 Natyra e gjykimit të çështjeve në Dhomën e Këshillimit nuk përbën cenim të standardeve kushtetuese të së drejtës për t'u dëgjuar dhe të së drejtës për t'u mbrojtur me avokat.

II

Vlerësimi i Gjykatës

A. Për pretendimin për papajtueshmëri me Kushtetutën në nenin 435/2 të Kodit të Procedurës Penale, të shprehjes: “Akti i rekursit dhe memoriet duhet të nënshkruhen, me pasojë mospranimi, nga mbrojtësit”

6. Kërkuesi ka kërkuar deklarinimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të shprehjes: “Akti i rekursit dhe memoriet duhet të nënshkruhen, me pasojë mospranimi, nga mbrojtësit”, që i përket nenit 435/2 të KPP-së. Subjekti i interesuar ka pretenduar se kërkuesi nuk legjitimohet të kërkojë shfuqizim të nenit 435/2 të KPP-së.

7. Gjykata ka vlerësuar se individët mund t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese për pretendime të lidhura me procesin e rregullt ligjor, kjo sipas nenit 131/f të Kushtetutës dhe 134/2 shkronja “g” e saj. Gjykata ka vlerësuar tashmë se neni 435/2 i KPP-së, i cili parashikon se rekursi dhe memoriet që i drejtohen Gjykatës së Lartë duhet të nënshkruhen nga mbrojtësit e të pandehurve, ka për qëllim të garantojë mbrojtjen me avokat të të pandehurit, në rastin kur ai ushtron rekurs. Gjykata, gjithashtu, ka vlerësuar se interpretimi pajtues që i ka bërë nenit 435/2 të KPP-së, është në favor të garancive të kërkuesit për të mos e humbur të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës. Nga kjo pikëpamje, Gjykata thekson se kërkuesit, si një subjekt me legjitimitet të kushtëzuar, në kuptim të nenit 134, pika 2 të Kushtetutës, për rastin në shqyrtim, i mungon interesi për të kërkuar shfuqizimin si antikushtetues të dispozitës procedurale (*shih vendimin nr.26, datë 13.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Për pasojë, Gjykata konkludon se kërkuesi nuk legjitimohet të kundërshtojë nenin 435/2 të KPP-së.

B. Për pretendimin për papajtueshmëri me Kushtetutën, në vendimin e Kolegjeve të Bashkuara nr.5, datë 15.9.2009, të shprehjes: “Rekursi penal të nënshkruhet nga mbrojtësi, në të kundërt ai nuk pranohet për shqyrtim në Gjykatën e Lartë”

8. Kërkuesi ka kërkuar deklarinimin si të papajtueshëm me Kushtetutën në vendimin e Kolegjeve të Bashkuara nr.5, datë 15.9.2009, të shprehjes: “Rekursi penal të nënshkruhet nga mbrojtësi, në të kundërt ai nuk pranohet për shqyrtim në Gjykatën e Lartë”.

9. Kontrolli kushtetues që ushtron Gjykata Kushtetuese ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të çdo individi për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit e të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete, nuk përbëjnë juridiksion kushtetues përderisa ato nuk shoqërohen me cenimin e të drejtave të lartpërmendura (*shih vendimin nr.31, datë 1.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Gjykata konstaton se kërkuesi nuk ka qenë palë ndërgjyqëse në çështjen me anë të së cilës është bërë unifikimi i praktikës së gjykatave nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, prandaj dhe lidhur me këtë pjesë të objektit, kërkuesi nuk legjitimohet.

C. Për pretendimin për papajtueshmëri me Kushtetutën të vendimeve nr.355, datë 12.3.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr.40, datë 23.1.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr.607, datë 6.11.2009 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

1. Për pretendimin se gjykatat nuk kanë vlerësuar drejt provat dhe nuk kanë pranuar kërkesat për marrje të provave, në kundërshtim me parimin e barazisë së armëve

11. Kërkuesi pretendon se si në fazën e hetimeve, ashtu dhe gjatë procesit gjyqësor në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatën e Apelit, i është refuzuar e drejta e marrjes së provave dhe vlerësimi i duhur i tyre, të cilat do të ndikonin drejtpërdrejt në dhënien e pafajësisë.

12. Gjykata konstaton se kërkuesi i ka parashtruar këto pretendime në të gjitha shkallët e gjyqimit deri në paraqitjen e rekursit në Gjykatën e Lartë, në përputhje me nenin 131/f të Kushtetutës, sa i përket plotësimit të kriterit të ezaurimit efektiv të mjeteve të ankimit.

13. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pranuar në mënyrë të vazhdueshme se marrja dhe vlerësimi i fakteve dhe i rrethanave, interpretimi i ligjit material dhe procedural dhe aplikimi i tij në çështjet konkrete janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues (shih vendimin nr.14, datë 3.6.2009 të Gjykatës Kushtetuese). Mënyra e vlerësimit të provave është atribut i gjykatave të zakonshme që zgjidhin çështjen konkrete dhe nuk i nënshtrohet kontrollit të saj kushtetues. Gjykata ka theksuar se kërkesa për marrje provash jo domosdoshmërisht duhet të pranohet nga gjykata dhe se vlerësimi i tyre është kompetencë e gjykatave të zakonshme (shih vendimin nr.106, datë 1.8.2001 të Gjykatës Kushtetuese). Në këtë kuptim Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet, sepse pretendimi në lidhje me refuzimin e marrjes së provave dhe vlerësimi jo i duhur i tyre, nuk përbëjnë pretendim në kuptimin kushtetues të procesit të rregullt ligjor.

2. Për pretendimin se nuk i është dhënë e drejta e mbrojtjes me avokat nga gjykatat, në kundërshtim me nenin 31/ç dhe nenin 42 të Kushtetutës

14. Kërkuesi ka pretenduar se nuk i është dhënë e drejta e mbrojtjes me avokat nga gjykatat, në kundërshtim me nenin 31/ç dhe nenin 42 të Kushtetutës.

15. Gjykata vlerëson se e drejta e palëve për të qenë të pranishme dhe për t'u mbrojtur në procesin gjyqësor, janë aspekte të rëndësishme të procesit të rregullt në kuptimin kushtetues. Në mënyrë konstante, në një sërë vendimesh të saj, Gjykata e ka pranuar ekzistencën e mbrojtjes si tregues thelbësor të një procesi të rregullt penal. Që e drejta e mbrojtjes të jetë reale dhe efektive dhe jo vetëm teorike, ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por përkundrazi, gjykata duhet të marrë të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të drejtë, jo vetëm të sigurojë praninë e mbrojtësit në gjykim, por dhe t'i japë atij mundësinë të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar barazinë e armëve (shih vendimet nr.5, datë 17.2.2003 dhe nr.33, datë 24.11.2003 të Gjykatës Kushtetuese). E drejta e gjithkujt, të akuzuar penalisht, për të qenë efektivisht i mbrojtur nga një avokat, kur është e nevojshme edhe i caktuar kryesisht, është një nga tiparet themelore të një gjykimi të drejtë (shih vendimin nr.25, datë 10.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese).

16. Në rastin në shqyrtim, Gjykata konstaton se në gjykimin në shkallë të parë, si dhe në gjykimin në apel kërkuesit i është caktuar mbrojtës kryesisht. Në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, ai nuk ka ushtruar të drejtën e tij për të kërkuar ndihmë juridike sipas ligjit nr.10 039, datë 22.12.2008 "Për ndihmën juridike", sipas të cilit të drejtën për të fituar ndihmë juridike e kanë personat që kërkojnë të mbrohen me avokat në procesin penal në të gjitha fazat e tij.

17. Prandaj dhe kjo Gjykatë çmon se pretendimi i kërkuesit për shkelje të së drejtës së mbrojtjes me avokat, është i pabazuar.

3. Për pretendimin se vendimet e gjykatave nuk janë të arsyetuara në kundërshtim me nenin 142/1 dhe 42 të Kushtetutës

18. Gjykata konstaton se kërkuesi nuk i ka ngritur pretendimet për mosarsyetim të vendimeve gjyqësore në ankimin në Gjykatën e Apelit dhe në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë. Në këto kushte, Gjykata çmon se kërkuesi nuk i ka shteruar mjetet juridike për mbrojtjen e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, parakusht ky i sanksionuar në nenin 131 shkronja "f" të Kushtetutës. Për rrjedhojë, për të dyja vendimet e dhëna nga Gjykata e Rrethit dhe Apelit ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim nga Gjykata Kushtetuese (shih vendimin nr.1, datë 25.1.2010; nr.18, datë 18.5.2011 të Gjykatës Kushtetuese). Kjo gjykatë do të vlerësojë pretendimin

për cenimin e këtij standardi vetëm për vendimin nr.607, datë 6.11.2009, dhënë nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

19. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar domosdoshmërinë e arsytimit të vendimeve gjyqësore si një garanci për procesin e rregullt ligjor (*shih vendimet nr.8, datë 16.3.2011; nr.38, datë 30.12.2010; nr.7, datë 9.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Edhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) ka theksuar se një funksion tjetër i arsytimit të vendimit është t'u demonstrrojë palëve se ata janë dëgjuar. Për më tepër, një vendim i arsyetuar i jep mundësinë palëve ta apelojnë atë, si dhe organeve të apelit ta shqyrtojnë. Vetëm duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimin Sarban kundër Moldavisë, prg.98, datë 4 tetor 2005*).

20. GJEDNJ-ja është shprehur për arsytimin e vendimeve, se detyrimi i gjykatave për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështje konkrete dhe natyrës së vendimit (*Hirvisaari kundër Finlandës, prg. 30, vendim i datës 27 shtator 2001*). GJEDNJ-ja ka theksuar ndërmjet të tjerave se: “Arsyetime i kufizuar i dhënë nga Gjykata e Lartë në formulimin e vendimit në Dhomë Këshillimi, në mënyrë të nënkuptuar evidenton se aplikanti nuk ka ngritur një nga argumentet ligjore të përcaktuara në dispozitën përkatëse të legjislacionit të brendshëm, i cili është kusht për pranimin e kërkesës (*Marini kundër Shqipërisë, datë 18 dhjetor 2007, prg.106*). Kur një Gjykatë e Lartë refuzon të pranojë një çështje për arsye se mungojnë shkaqet ligjore për ngritjen e çështjes, një arsyetim shumë i kufizuar mund të përmbushë kriterin e nenit 6 të Konventës” (*mutatis mutandis, Mishgjoni kundër Shqipërisë, datë 7 dhjetor 2010 prg.51, dhe Nerva kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 11 korrik 2000*).

21. Në vlerësimin e Gjykatës, nuk rezulton që vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë të jetë jologjik, të ketë kundërthënie, të mos ketë referencë në ligjin e zbatueshëm, prandaj dhe pretendimi se vendimi i Gjykatës së Lartë është i paarsyetuar, është i pabazuar.

4. Për pretendimin se i është mohuar aksesin në Gjykatën e Lartë

22. Kërkuesi pretendon se Gjykata e Lartë i ka mohuar aksesin për shkak të mospranimit të rekursit të panënskruar nga mbrojtësi. Sipas tij, sekretaria e kësaj gjykatë duhet t'i kishte dhënë mundësinë e plotësimit të rekursit sipas kërkesave të ligjit.

23. Në jurisprudencën e saj të mëparshme, Gjykata ka mbajtur qëndrimin se: “Në situatën në të cilën kërkuesi ka ushtruar rekursin, në përmbushje të detyrimeve të tij formale që përcaktohen kryesisht në nenet 410, 412, 420, 435/1 të KPP-së dhe rekursi nuk është nënskruar nga mbrojtësi i zgjedhur prej tij, ai nuk mund të privohet nga e drejta që rekursi i tij të vlerësohet sipas përcaktimeve të nenit 432 të KPP-së. Në këtë vështrim, Gjykata vlerëson se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, para se të vendosë mospranimin e rekursit për shkak të mosnënskruarit të tij nga mbrojtësi, duhet të verifikojë nëse sekretaria gjyqësore ka zbatuar detyrimin ligjor për vënien në dijeni të të pandehurit, për të plotësuar rekursin me nënskrimin nga mbrojtësi, sipas kuptimit që vetë Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin unifikues nr.5, datë 15.9.2009, i kanë dhënë nenit 415/2 të KPP-së. Këto kërkesa ligjore kanë rëndësi kushtetuese, sepse garantojnë realisht të drejtën e individit për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë” (*shih vendimin nr.38, datë 30.12.2010; nr.26, datë 13.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuesi ka depozituar brenda afatit ligjor, pranë sekretarisë së gjykatës që ka dhënë vendimin, një rekurs i cili nuk ka qenë i nënskruar nga mbrojtësi i tij. Gjykata konstaton se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr.607, datë 6.11.2009 në pjesën hyrëse ka evidentuar faktin se rekursi nuk është nënskruar nga mbrojtësi, por në pjesën arsyetuese, si dhe në dispozitiv është mbështetur në nenet 433/2 dhe 435/1 të KPP-së. Sipas nenit 435/1 të KPP-së, rekursi duhet të paraqitet brenda 30 ditëve që vendimi ka marrë formë të prerë. Ai duhet të përmbajë tregimin e saktë të shkaqeve të paligjshmërisë së vendimit, ndërsa sipas nenit 433 të KPP-së, rekursi nuk pranohet në qoftë se bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që lejon ligji.

25. Gjykata është shprehur se e gjithë veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit, është një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj (*shih vendimin nr.4, datë 25.2.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo gjykatë konstaton se

refuzimi i rekursit nuk është bërë për shkak të mosnënshkrimit të tij nga mbrojtësi, por sepse nuk ka plotësuar kriterin ligjor të tregimit të shkaqeve të paligjshmërisë, si një nga kriteret për selektimin dhe refuzimin/pranimin e rekurseve.

26. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se kërkesa duhet rrëzuar për shkak se nuk evidentohen në pretendimet e kërkuarit standarde të cenuara të procesit të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f e 134/g të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Sokol Sadushi Vitore Tusha, Petrit Pllloçi, Altina Xhoxhaj, Admir Thanza, Sokol Berberi.

VENDIM

Nr.38, datë 20.9.2011

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Anëtar i	Gjykatës Kushtetuese	
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare e	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar i	“	“
Sokol Berberi	Anëtar i	“	“
Admir Thanza	Anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare e	“	“
Petrit Pllloçi	Anëtar i	“	“

me sekretare Blerina Çinari, në datat 7.12.2010, 24.3.2011 dhe 29.3.2011, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.30/15 akti, që i përket:

KËRKUESE: Fatime Dollani e përfaqësuar nga av.Leonard Lame dhe av.Artan Linani me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Enver Rrapaj, Ferdinand Hodo të përfaqësuar nga av.Vasil Dole, me prokurë.

- Ferdinand Dollani i përfaqësuar nga av.Leonard Lame dhe av.Artan Linani, me prokurë.

- Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) Elbasan përfaqësuar nga Alma Pavoja dhe Fatmir Kasemi, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr.532, datë 27.4.2006 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe kthimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42/2, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Petrit Pllloçi, përfaqësuesin e kërkuarit që kërkoi pranimin e kërkesës, përfaqësuesin e subjektit të interesuar, i cili kërkoi rrëzimin e kërkesës, dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Kërkuarja i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Elbasanit, duke kërkuar me padi njohjen si bashkëpronare mbi një send të paluajtshëm, pjesë e pasurisë bashkëshortore, si dhe konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratave të shitjes së kësaj pasurie, të tjetërsuar nga bashkëshorti i saj në favor të personave të tretë pa pëlqimin saj.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr.881, datë 4.6.2003, ka vendosur pranimin e kërkesëpadsisë. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr.30, datë 5.2.2004 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.881 datë 4.6.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, duke saktësuar konstatimin e pavlefshmërisë së kontratës së shitjes vetëm për pjesën e pasurisë bashkëshortore që i takonte kërkuarës. Mbi rekursin e subjektit të interesuar Enver Rrapaj, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.532, datë 27.4.2016 ka vendosur ndryshimin e vendimit nr.30, datë 5.2.2004 të Gjykatës së Apelit Durrës, të vendimit nr.881, datë 4.6.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe rrëzimin e kërkesëpadsisë.

Kërkuarja pretendon cenim të së drejtës së saj kushtetuese për një proces të rregullt ligjor duke parashtruar se:

Gjykimi në Gjykatën e Lartë është zhvilluar pa dijeninë dhe praninë e saj, për shkak se “dëftesat e komunikimit” në emrin e saj dhe të bashkëshortit për njoftimin e rekursit të ushtruar nga subjekti i interesuar janë të falsifikuara. Falsifikimin e këtij dokumenti kërkuarja e bazon në aktet e procedimit penal të “falsifikimit të dokumenteve” të filluar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Ky procedim është pushuar për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale.

Subjektet e interesuara Enver Rrapaj dhe Ferdinand Hodo, nëpërmjet përfaqësuesit të tyre, parashtruan si prapësim mungesën e legjitimitetit për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese nga ana e kërkuarës, për shkak se, sipas tyre ajo e kishte paraqitur kërkesën përpara kësaj Gjykate tej afatit ligjor 2-vjeçar, të parashikuar nga neni 30 i ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

II

Në lidhje me legjitimitetin e kërkuarës

Gjykata Kushtetuese (Gjykata) thekson se legjitimiteti “*ratione personae*” i individit për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese parashikohet nga neni 131 shkronja “f” dhe neni 134 shkronja “g” i Kushtetutës, ndërsa legjitimiteti “*ratione temporis*” i këtij lloji kërkuarje parashikohet nga neni 30/2 i ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, dhe në këtë drejtim nuk ka ndonjë dyshim, për sa i përket legjitimitetit.

Gjykata konstaton se, në rastin në shqyrtim, kundërshtitë kanë lindur në lidhje me legjitimitetin “*ratione temporis*” të kërkuarës, për arsye se kërkuarja pretendon se kërkesën e ka paraqitur përpara Gjykatës Kushtetuese brenda afatit 2-vjeçar që parashikon neni 30/2 i ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”. Konkretisht, kërkuarja ka pretenduar se lidhur me vendimin e Kolegjit Civil, objekt kundërshtimi kushtetues, ajo është njoftuar me anë të shkresës nr.1604/1 prot., datë 15.10.2009 të ZVRPP-së Elbasan. Nga ana e tij, përfaqësuesi i subjekteve të interesuara Enver Rrapaj dhe Ferdinand Hodo, ka pretenduar se kërkuarja është vënë në dijeni për ekzistencën e këtij vendimi që në vitin 2006.

Gjykata Kushtetuese, duke qenë se në rastin në shqyrtim, përcaktimi i kohës së marrjes dijeni mbi vendimin Kolegjit Civil, objekt kundërshtimi kushtetues nga ana e kërkuarës, ishte e

lidhur me veprimtarinë administrative të ZVRPP-së Elbasan, e cila nuk ishte paraqitur në seancën e datës 7.12.2010, vendosi të riçelë shqyrtimin gjyqësor më datën 24.3.2011, duke kërkuar që ky subjekt i interesuar të jepte shpjegime, si dhe të paraqiste ato akte të tij që pasqyronin kohën e marrjes dijeni mbi këtë fakt nga ana e kërkuases. Nga shpjegimet e dhëna nga ana e përfaqësuesve të ZVRPP-së Elbasan, si dhe nga aktet që kjo zyrë i paraqiti Gjykatës, përmbajtja e të cilave ju bë e njohur edhe palëve të tjera, nuk u vërtetua që kërkuësja të kishte marrë dijeni mbi vendimin e Kolegjit Civil përpara datës 15.10.2009, datë në të cilën ajo ishte njoftuar nëpërmjet shkresës nr.1604/1 prot., datë 15.10.2009 të ZVRPP-së Elbasan. Si rrjedhim, Gjykata çmon se, kërkuësja legjitimohet “*ratione temporis*” për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, sepse kërkesën objekt shqyrtimi e ka paraqitur përpara kësaj Gjykate brenda afatit ligjor.

Në lidhje me cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës

Kërkuësja ka pretenduar se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është rezultat i një procesi jo të rregullt ligjor, për arsye se gjykimi është zhvilluar në mungesë të saj, pa patur njoftim.

Kërkuësja, pretendimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, e mbështet në faktin se gjykimi në Gjykatën e Lartë është zhvilluar pa dijeninë e saj, për shkak se “dëftesat e komunikimit” në emrin e saj dhe të bashkëshortit për njoftimin e rekursit të ushtruar nga subjekti i interesuar, janë të falsifikuara.

Lidhur me këtë pretendim Gjykata vë në dukje se, bazuar në legjislacionin procedural civil, “dëftesa e komunikimit” të rekursit është një akt procedural, e cila bashkë me njoftimin me shpallje në Gjykatën e Lartë, siguron njoftimin e palëve për të marrë pjesë në gjykim. Për këtë arsye, Gjykata Kushtetuese, vlerëson se çdo e metë/pavlefshmëri ose, çdo falsitet i “dëftesës së komunikimit” të rekursit cenon edhe të drejtën kushtetuese për t’u mbrojtur, gjë që e bën procesin jo të rregullt nga këndvështrimi kushtetues.

Gjykata Kushtetuese konstaton se kërkuësja, pretendimin për falsitetin e “dëftesës së komunikimit” të rekursit, e bazon në aktin e ekspertimit grafik të kryer në kuadrin e procedimit penal të “falsifikimit të dokumenteve”, procedim që është pushuar për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale. Gjykata Kushtetuese, duke qenë se vendimi që ka përfunduar procedimin penal, nuk është një vendim gjyqësor dhe si i tillë nuk zotëron fuqinë dhe efektet detyruese të parashikuara nga neni 70 i Kodit të Procedurës Penale, çmon se jashtë këtij procedimi, në cilësinë e provës, ky akt ekspertimi, si çdo provë tjetër, i nënshtrohet debatit gjyqësor dhe vlerësimit të lirë të Gjykatës. Gjykata Kushtetuese, duke iu përmbajtur qëndrimit se falsiteti i “dëftesës së komunikimit” të rekursit çon në pavlefshmëri të këtij njoftimi, bazuar në nenin 1 pika 2 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 dhe në nenet 270-274 të Kodit të Procedurës Civile, të cilat lejojnë shqyrtimin e falsitetit të një akti në mënyrë incidentale gjatë zhvillimit të një procesi gjyqësor, vendosi që të riçelë më datën 24.3.2011, shqyrtimin gjyqësor në mënyrë që t’i jepej edhe një herë mundësi palëve që të shprehnin qëndrimin e tyre në lidhje me aktin e ekspertimit grafik të kryer në kuadrin e procedimit penal. Gjatë debatit gjyqësor rezultoi se, si përfaqësuesi i kërkuësit, ashtu edhe përfaqësuesi i subjekteve të interesuara, Enver Rrapaj dhe Ferdinand Hodo, nuk e kontestuan këtë akt, duke pranuar si të mirëqenë konkluzionin e dhënë në të. Për këtë arsye, Gjykata vendosi që në lidhje me falsitetin e “dëftesës së komunikimit” të rekursit në emrin e saj dhe të bashkëshortit të saj, të mos thërriste në bazë të nenit 40 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000, ekspertin e fushës, por të pranonte si të mirëqenë konkluzionin e aktit të ekspertimit olografik, sipas të cilët nënshkrimi në dëftesën e komunikimit të rekursit në emrin të kërkuëses dhe të bashkëshortit të saj nuk është nënshkrimi origjinal i tyre.

Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke zhvilluar gjykimin në mungesë të kërkuëses dhe të përfaqësuesit të saj, pa patur dijeni për rekursin e palës tjetër, ka cenuar të drejtën e saj për një proces të rregullt ligjor, parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/f të Kushtetutës dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Shfuqizimin e vendimit nr.532 datë 27.4.2006 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Vladimir Kristo, Xhezair Zaganjori, Sokol Berberi, Admir Thanza, Sokol Sadushi, Petrit Ploçi, Altina Xhoxhaj
Anëtare kundër: Vitore Tusha

VENDIM

Nr.39, datë 21.9.2011

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Vladimir Kristo	Anëtar	i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare	e	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar	i	“	“
Sokol Berberi	Anëtar	i	“	“
Admir Thanza	Anëtar	i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare	e	“	“
Petrit Ploçi	Anëtar	i	“	“

me sekretare Blerina Çinari, në datë 28.4.2011, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.11 akti, që i përket:

KËRKUESE: Aurora Topçiu e përfaqësuar nga avokat Fatmir Braka me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr.505, datë 14.10.2009 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42/2, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Petrit Ploçi, përfaqësuesin e kërkuarit që kërkoi pranimin e kërkesës dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr.185, datë 13.12.2006, ka vendosur deklarimin fajtor të kërkuarës për veprën penale “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake”, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal dhe dënimin e saj me 450.000 lekë gjobë.

Gjykata e Apelit Gjirokastër, me vendimin nr.79, datë 16.5.2007, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr.185, datë 13.12.2006 të Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër, deklarimin fajtor të kërkueses për veprën penale “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe e municionit”, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal dhe dënimin e saj me 450.000 lekë gjobë, dhe në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale kërkueses i ulet 1/3 e dënimit duke u dënuar përfundimisht me 300.000 lekë gjobë.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.505, datë 14.10.2009, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesja ndaj vendimit nr.79 datë 16.5.2007 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, me arsyetimin se nuk është paraqitur në formën e kërkuar nga ligji, pasi mungon nënshkrimi i mbrojtësit sipas nenit 435/2 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

Kërkuesja ka pretenduar cenimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor për sa i përket mohimit të aksesit në Gjykatën e Lartë.

Konkretisht, kërkuesja ka parashtruar se rekursi i saj nuk është shqyrtuar në themel nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, sepse kjo gjykatë ka vendosur mospranimin për gjykim të tij vetëm për mosplotësim të kriterëve formale, siç është nënshkrimi i rekursit nga mbrojtësi (neni 435/2 i KPP). Kërkuesja pretendon se mungesa e nënshkrimit të mbrojtësit, në rekursin e ushtruar prej saj, nuk mund të sjellë detyrimisht mohimin e së drejtës për t’u dëgjuar dhe për të marrë përgjigje mbi shkaqet e ngritura në recurs. Këtë pretendim kërkuesja e mbështet edhe në vendimin nr.38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese.

II

Lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës për t’iu drejtuar gjykatës (e drejta e aksesit në gjykatë)

Kërkuesja Aurora Topçiu, në kërkesën drejtuar kësaj gjykate, ka pretenduar se Gjykata e Lartë, duke vendosur mospranimin për gjykim të rekursit me arsyetimin se në kundërshtim me nenin 435/2 të KPP-së, nuk është nënshkruar nga mbrojtësi, i ka cenuar asaj të drejtën për t’iu drejtuar kësaj gjykate (aksesin), parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese, rithekson se e drejta për t’iu drejtuar gjykatës (aksesi në gjykatë) është një aspekt i së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Mohimi i së drejtës për t’iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj, lidhur me pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së (*shih vendimet nr.38, datë 30.12.2010, nr.5, datë 2.3.2011, nr.8, datë 16.3.2011, nr.9, datë 29.3.2011, nr.10, datë 29.3.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj ka vënë në dukje se e drejta për t’iu drejtuar një gjykate nuk është absolute. Kjo e drejtë mund të jetë objekt kufizimesh, të cilat nënkuptohen, përderisa kjo e drejtë, nga natyra e saj, kërkon rregullim nga ana e shtetit (*shih vendimin e GjEDNJ-së në çështjen Treska kundër Shqipërisë, nr.26937/04 i aplikimit*). Megjithatë, këto kufizime nuk duhet të jenë të tilla sa të dëmtojnë vetë thelbin e së drejtës. Gjykata Kushtetuese është shprehur, gjithashtu, se përdorimi i mjetit procedural të përshtatshëm ankimues, siç sanksionohet në KPP-në, përbën një kërkesë që lidhet me thelbin e së drejtës së mbrojtjes dhe të pjesëmarrjes aktive në gjykim. Mosgjykimi në themel i shkaqeve të rekursit, cenon të drejtën e aksesit të tij në Gjykatën e Lartë (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.21, datë 24. 7.2006*). Gjykata Kushtetuese vlerëson, gjithashtu, se megjithëse formalizmi është një domosdoshmëri e procesit, është e domosdoshme të shmanget një formalizëm i tepërt procedural, që do të çonte në cenimin e thelbit të së drejtës.

Për sa më sipër, Gjykata Kushtetuese vlerëson se, edhe parashikimi ligjor i nenit 435/2 të Kodit të Procedurës Penale, nuk mund të interpretohet në një mënyrë të tillë, që do të cenonte thelbin e të drejtës së një individi për t’iu drejtuar Gjykatës së Lartë. Për këtë arsye, Gjykata Kushtetuese, për të garantuar të drejtën e një individi për t’iu drejtuar Gjykatës së Lartë, zbatimin e nenit 435/2 të Kodit të Procedurës Penale e ka parë në raport me rregullimet e përgjithshme që disjunojnë paraqitjen e ankimit (nenet 407- 421 e KPP-së), si dhe ato të veçanta për paraqitjen e rekursit (nenet 431-435 të KPP-së). Kështu, Gjykata, në vendimin nr.5, datë 2.3.2011, si dhe në 6104

vendimet e saj të mëpasshme është shprehur se, në situatën në të cilën kërkuesi ka ushtruar rekursin, në përmbushje të detyrimeve të tij formale, që përcaktohen kryesisht në nenet 410, 412, 420, 435/1 të KPP-së dhe rekursi nuk është nënshkruar nga mbrojtësi i zgjedhur prej tij, ai nuk mund të privohet nga e drejta që rekursi i tij të shqyrtohet në themel, vetëm për mungesë të nënshkrimit të mbrojtësit. Një interpretim i ndryshëm, që mund t'i bëhet nenit 435/2, sjell si pasojë cenimin e së drejtës së individit për akses në Gjykatën e Lartë (*shiko vendimin nr.38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

Gjykata Kushtetuese në rastin në shqyrtim konstaton se, me vendimin objekt kundërshtimi kushtetues, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesja, me arsyetimin se nuk është paraqitur në formën e kërkuar nga ligji, pasi i mungon nënshkrimi i mbrojtësit sipas nenit 435/2 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

Gjykata Kushtetuese, në rrethanat e mësipërme, arrin në konkluzionin se gjatë gjykimit të çështjes në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, kërkueses Aurora Topçiu, në kundërshtim me nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, i është cenuar e drejta për t'iu drejtuar gjykatës (aksesi në gjykatë).

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/f të Kushtetutës dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Shfuqizimin e vendimit nr. 505, datë 14.10.2009 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Sokol Sadushi Vitore Tusha, Petrit Pllloçi, Altina Xhoxhaj, Admir Thanza, Sokol Berberi

VENDIM

Nr.40, datë 22.9.2011

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	Anëtar i	"	"
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	"	"
Petrit Pllloçi	Anëtar i	"	"
Vitore Tusha	Anëtare e	"	"
Sokol Sadushi	Anëtar i	"	"
Sokol Berberi,	Anëtar i	"	"
Admir Thanza	Anëtar i	"	"
Altina Xhoxhaj	Anëtare e	"	"

me sekretare Blerina Çinari, në datë 18.11.2010, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.25/10 akti, që i përket:

KËRKUES: Aurel Kota, përfaqësuar nga avokati Përparim Sanxhaku, me prokurë të posaçme.

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme, përfaqësuar nga prokurori Artur Selmani, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimeve: nr.101, datë 7.4.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; nr.117, datë 26.10.2007 të Gjykatës së Apelit Korçë; nr.184, datë 3.3.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42/2, 32/2, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatoren e çështjes, Altina Xhoxhaj, përfaqësuesin e kërkuarit që kërkonte pranimin e kërkesës, përfaqësuesin e subjektit të interesuar që kërkonte rrëzimin e kërkesës dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Me vendimin nr.101, datë 7.4.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, i pandehuri Aurel Kota (kërkuari) është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale të shfrytëzimit të prostitucionit në rrethana rënduese dhe, bazuar në nenin 114/a/5 të Kodit Penal, është dënuar me 7 vjet burgim.

2. Me vendimin nr.114, datë 17.10.2003 të Gjykatës së Apelit Korçë, është vendosur prishja e vendimit nr.101, datë 7.4.2003 dhe pushimi i gjykimit të çështjes në ngarkim të kërkuarit.

3. Me vendimin nr.256, datë 19.5.2004, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, është vendosur prishja e vendimit të mësipërm të gjykatës së apelit dhe kthimi i akteve po asaj gjykate për rishqyrtimin e çështjes.

4. Me vendimin nr.135, datë 11.11.2004 të Gjykatës së Apelit Korçë, është vendosur prishja e vendimit nr.101, datë 7.4.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe pushimi i gjykimit të çështjes në ngarkim të kërkuarit.

5. Me vendimin nr.849, datë 14.12.2005 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, është vendosur prishja e vendimit të mësipërm të gjykatës së apelit dhe kthimi i akteve po asaj gjykate për rishqyrtimin e çështjes.

6. Me vendimin nr.117, datë 26.10.2007 të Gjykatës së Apelit Korçë, është lënë në fuqi vendimi nr.101, datë 7.4.2003 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

7. Me vendimin nr.184, datë 3.3.2010, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr.117, datë 26.10.2007 të Gjykatës së Apelit Korçë.

8. Me kërkesën datë 29.9.2010 kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës.

9. **Kërkuari** pretendon se procesi gjyqësor në ngarkim të tij është jokushtetues dhe kërkon shfuqizimin e vendimeve të mësipërme të gjykatave të tri shkallëve, që e kanë deklaruar atë fajtor, duke parashtruar në thelb se:

i) Gjykatat kanë cenuar nenin 32/2 të Kushtetutës, sepse kërkuari është deklaruar fajtor mbi bazën e një prove të marrë në mënyrë të paligjshme. Dëshmia e shtetases NC është marrë në kundërshtim me nenin 158 (pika 1 shkronja “ç” dhe pika 2) të Kodit të Procedurës Penale (KPP), sepse ajo nuk është vënë në dijeni për të drejtën për të mos dëshmuar.

ii) Sigurimi i provës (dëshmisë) i datës 11.11.2002 është bërë nga i njëjti gjyqtar që ka dhënë edhe vendimin për caktimin e masës së sigurimit për kërkuarin, në kundërshtim me nenin 15/2 të KPP-së. Edhe në këtë kuptim kjo provë është marrë në mënyrë të paligjshme.

iii) Gjykatat kanë cenuar të drejtën e kërkuarit për një mbrojtje efektive dhe reale. Gjatë gjithë këtij procesi janë angazhuar 6 avokatë (të zgjedhur nga i pandehuri ose të caktuar kryesisht nga gjykata), të cilët kanë zvarritur çështjen, nuk kanë bërë parashtrësia përpara gjykatës, nuk kanë kundërshtuar provat e kërkuara nga prokurori, nuk kanë kërkuar marrjen e provave në favor të

kërkuesit, kanë hequr dorë nga pyetja e dëshmitarëve, nuk kanë bërë kundërrekurs dhe nuk kanë marrë pjesë në dy gjykime të zhvilluara në Gjykatën e Lartë.

iv) Gjykata e Lartë, për sa i përket vendimeve të saj nr.256, datë 19.5.2004 dhe nr.849, datë 14.12.2005, edhe pse e vënë në lëvizje nga prokurori, ka zhvilluar seancat gjyqësore në mungesë të mbrojtësit të kërkuesit.

10. *Përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Prokuroria e Përgjithshme*, në mënyrë të përmbledhur, argumentoi se:

- Mosrespektimi i detyrimit që rrjedh nga neni 158 i KPP-së, passjell pavlefshmërinë relative të dëshmisë, çka kërkon ngritjen e këtij pretendimi brenda një afati të caktuar. Nga aktet e dosjes gjyqësore nuk rezulton që pretendimi për pavlefshmërinë e dëshmisë së shtetases NC të jetë ngritur para nisjes së shqyrtimit gjyqësor. Në këto kushte, kjo parregullsi nuk ka aftësinë të bëjë aktet e mëpasme absolutisht të pavlefshme dhe, për pasojë, nuk mund të konkludohet se është zhvilluar një proces jo i rregullt ligjor.

- Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim, jo në çdo rast konstatimi i saj përbën prekje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Duke iu referuar përmbajtjes së vendimit për caktimin e masës së sigurimit ndaj kërkuesit, gjyqtari ka mbajtur një qëndrim thjesht juridiko-formal, duke parashtuar vetëm bazueshmërinë në ligj të kërkesës për caktimin e masës së sigurimit dhe nuk ka bërë asnjë koment në drejtim të provave konkrete.

- Në lidhje me pretendimet për mossigurimin e një mbrojtjeje efektive, ato i referohen gjykimeve të zhvilluara para se të merreshin vendimet gjyqësore që pretendohen si jokushtetuese. Gjithsesi, nga materialet e dosjes gjyqësore rezulton se gjatë gjykimit mbrojtja ka marrë pjesë aktive në gjykim duke bërë edhe kërkime konkrete. Strategjitë e gabuara të mbrojtjes nuk mund të hyjnë në kuptimin e një mbrojtjeje joefektive.

II

A. Në lidhje me pretendimin për cenim të nenit 32/2 të Kushtetutës

11. Gjykata vëren se neni 32, pika 2, i Kushtetutës parashikon se askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme. Ky parim i rëndësishëm është trajtuar nga jurisprudenca shqiptare dhe ajo e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), si pjesë përbërëse e procesit të rregullt ligjor dhe veçanërisht në drejtim të respektimit të së drejtës për t'u mbrojtur, e cila kërkon që i akuzuari të ketë mundësitë e duhura për të njohur dhe komentuar çdo provë që i paraqitet gjykatës.

12. Në jurisprudencën e saj konstante, Gjykata ka theksuar se pranimi dhe çmuarja e provave është çështje që u takon gjykatave të zakonshme. Detyra e Gjykatës është të vlerësojë nëse procesi i realizuar në këto gjykata, i shqyrtuar si i tërë, duke përfshirë edhe procedurën lidhur me mënyrën si janë siguruar këto prova, ka qenë i drejtë.

13. Si aspekt të cenimit të nenit 32/2 të Kushtetutës, kërkuesi ka parashtuar mosrespektimin e rregullave procedurale që parashikojnë përjashtimin e një kategorie subjektesh nga detyrimi për të dëshmuar. Konkretisht, kërkuesi pretendon se dëshmia e shtetases NC është marrë në mënyrë të paligjshme, pasi gjykata, në kushtet kur kjo dëshmitare kishte bashkëjetuar me kërkuesin, duhej t'i bënte të ditur asaj të drejtën për të mos dëshmuar, bazuar në nenin 158/2 të KPP-së.

14. Gjykata vëren se neni 158 i KPP-së (përjashtimet nga detyrimi për të dëshmuar) parashikon se:

“1. Nuk janë të detyruar të dëshmojnë: ... ç- ai që, edhe pse nuk është bashkëshort i të pandehurit, bashkëjeton ose ka bashkëjetuar me të.

2. Gjykata u bën të njohur personave të mësipërm të drejtën për të mos dëshmuar dhe i pyet ata nëse duan të përfitojnë nga kjo e drejtë. Mosrespektimi i këtij rregulli e bën të pavlefshme dëshminë”.

15. Për shkak të ruajtjes së marrëdhënieve shoqërore të rëndësishme, sikundër janë ato mes gjinisë ose krushqisë së afërt, bashkëshortit ose bashkëjetuesit me të pandehurin, ligjvënësi e ka përjashtuar këtë rreth subjektesh nga detyrimi për të dëshmuar gjatë gjykimit që zhvillohet në ngarkim të të afërmit të tyre. Ligjvënësi i ka njohur një status të veçantë këtyre personave, duke

parashikuar detyrimin për gjykatën që, në momentin e administrimit të dëshmisë, t'u bëjë atyre të njohur të drejtën për të mos dëshmuar.

16. Edhe pse ky është rregull, Gjykata vëren se parashikimi i nenit 158/2 të KPP-së konfigurohet jo si pengesë absolute për të dëshmuar, por si mundësi për të hequr dorë nga dhënia e dëshmisë dhe karakterizohet nga autonomia e zgjedhjes personale, rast pas rasti, të dëshmitarit. Në çdo rast i takon subjektit të interesuar (dëshmitarit) të vlerësojë nëse do përfitojë ose jo nga kjo e drejtë. Në rast se subjekti nuk përfiton nga kjo e drejtë, pra ai vendos të dëshmojë, ai merr cilësinë e dëshmitarit si çdo subjekt tjetër, me të gjitha detyrimet ligjore, dhe dëshmia konsiderohet e marrë në mënyrë të ligjshme.

17. Gjykata vëren, gjithashtu, se dispozita procedurale e nenit 158, ka parashikuar edhe përjashtimin nga mosdetyrimi për të dëshmuar, në rastin kur subjekti ka paraqitur kallëzim ose ankim, ose ai vetë, ose një i afërm i tij, është dëmtuar nga vepra penale. Kufizimet e së drejtës për të mos dëshmuar janë parashikuar nga nevoja që të dëgjohen, në fazën e gjykimit, personat që kanë gjykuar të arsyeshme të kallëzojnë veprën e të afërmit të tyre dhe për këtë arsye kanë shprehur, nëpërmjet veprimeve të tyre, se e kanë tejkualuar konfliktin e brendshëm psikologjik midis detyrimit ligjor për të dëshmuar të vërtetën dhe detyrimit moral për të mos dëmtuar të afërmin e tyre.

18. Nga dosja gjyqësore rezulton se procedimi penal në ngarkim të kërkuesit Aurel Kota ka filluar mbi bazën e kallëzimit të shtetases NC, në cilësinë e bashkëjetueses me të pandehurin. Duke qenë se është kjo shtetase që ka vënë në lëvizje procedimin penal kundër kërkuesit, paraqitja e saj para gjykatës për sigurimin si provë të dëshmisë dhe thirrja e saj për të dëshmuar, në gjykimin në gjykatën e apelit, janë bërë në cilësinë e kallëzueses dhe jo në cilësinë e personit që ka dijeni për rrethanat apo faktet që kanë të bëjnë me ngjarjen. Në këto kushte, Gjykata vëren se nuk gjen zbatim parashikimi i nenit 158/2 të KPP-së, me pasojën që kjo shtetase kishte detyrimin të dëshmonte, dhe se për gjykatën nuk lindte asnjë detyrim për ta njoftuar atë për mundësinë/të drejtën për të hequr dorë nga dhënia e dëshmisë.

Për sa më sipër, pretendimi i kërkuesit për cenim të nenit 32/2 të Kushtetutës është i pabazuar.

B. Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim

19. Kërkuesi pretendon se në gjykimin e kësaj çështjeje është shkelur parimi i gjykimit nga një gjykatë e paanshme. Konkretisht, sipas kërkuesit, është cenuar neni 15 i KPP-së, pasi i njëjti gjyqtar që ka bërë sigurimin e provës (dëshmisë) ka caktuar edhe masën e sigurimit për kërkuesin.

20. Gjykata ka theksuar se gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, sanksionuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Gjykata ka theksuar në jurisprudencën e saj, se parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e vet subjektiv, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin objektiv me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimit prej saj të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim. Ndër të tjera, gjykata duhet të jetë e kujdesshme dhe të marrë parasysh veçanërisht problemin e përbërjes së trupit gjykues, në mënyrë që të mënjanohej nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk kanë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv. Në shtetin e së drejtës, kërkesa për një gjykim të paanshëm merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë, që në shoqëritë demokratike duhet ta krijojnë në çdo rast jo vetëm palët në gjykim, por dhe çdo qytetar i thjeshtë (*shih vendimet nr.12, datë 13.4.2007 dhe nr.21, datë 29.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Jurisprudenca e deritanishme e Gjykatës ka evidentuar se parimi i paanshmërisë në gjykim, edhe në këndvështrim të përbërjes së trupit gjykues, duhet të respektohet në çdo shkallë të gjykimit.

22. Gjykata vëren se, me qëllim të respektimit të parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, neni 15/2 i KPP-së parashikon se nuk mund të marrë pjesë në gjykim gjyqtari që ka vlerësuar masën e sigurimit ose çdo kërkesë tjetër të prokurorit të paraqitur gjatë hetimit paraprak në të njëjtin procedim. Ky detyrim parashikohet edhe nga neni 17/1/e i KPP-së, sipas të cilit gjyqtari duhet të heqë dorë nga gjykimi i çështjes konkrete kur ndodhet në një nga kushtet e papajtueshmërisë së parashikuar në nenin 15 të KPP-së.

23. Gjykata është shprehur se provat paraqiten dhe marrin vlerën e tyre në debatin gjyqësor, por mund të ndodhë që të dhënat për veprën, për shkak të natyrës së tyre, të ndryshojnë ose të zhduken. Për pasojë, paraqitja e tyre në gjykim bëhet e pamundur. Me qëllim që të ruhet vlera e të dhënave të konstatuara gjatë hetimeve paraprake është pranuar instituti i sigurimit të provës, në bazë të të cilit, në rastet e parashikuara me ligj, prova formohet në këtë fazë të procedimit nëpërmjet marrjes së saj nga gjykata, sipas parashikimeve të KPP-së (*shih vendimin nr.19, datë 18.9.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Gjykata vëren, gjithashtu, se në titullin VI të KPP-së, që rregullon fazën e hetimeve paraprake, përfshihen edhe procedura për sigurimin e provës (nenet 316-322 të KPP-së). Duke iu referuar nenit 320 (disponimi mbi kërkesën për sigurimin e provës) dhe nenit 321 (marrja e provës), del se midis tyre ka një ndryshim thelbësor. Në rastin e parë, gjykata disponon me vendim, duke vlerësuar nëse duhet marrë ose jo prova e kërkuar, kurse veprimi i kryer sipas nenit 321, për marrjen e provës, përbën një procedurë të thjeshtë e të domosdoshme pa u investuar gjykata me asnjë lloj vlerësimi (*shih vendimin nr.27, datë 1.10.2003 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Procedura e marrjes së provës, e rregulluar nga neni 321 i KPP-së, paraqet karakteristikat e shqyrtimit gjyqësor, për arsye se gjatë këtij procesi gjyqtari kryen një pjesë të shqyrtimit gjyqësor, që është administrimi i provave. Kjo konfirmohet edhe nga parashikimi i nenit 321, i cili kërkon pjesëmarrjen e domosdoshme të prokurorit dhe të mbrojtësit të të pandehurit, me pasojë mospërdorimin e saj në shqyrtimin gjyqësor (neni 322), si dhe praninë e të pandehurit dhe të dëmtuarit kur duhet të pyetet një dëshmitar ose një person tjetër. Bazuar në dispozitat procedurale, sigurimi i provës bëhet në format e përcaktuara për debatin gjyqësor dhe mbrojtësi i të pandehurit mund t'i drejtojë pyetje personit që është thirrur të dëshmojë. Si e tillë, kjo provë ka të njëjtën vlerë me provat e marra gjatë shqyrtimit gjyqësor nga gjykata që shqyrton në themel çështjen.

26. Gjykata rithekson se ligji nuk përjashton, që gjyqtari i cili ka shqyrtuar një kërkesë gjatë hetimit paraprak, të shqyrtojë një kërkesë tjetër të të njëjtit lloj apo të një lloji tjetër në të njëjtin procedim, por parimi është që gjyqtari që ka vlefësuar çdo kërkesë të prokurorit gjatë hetimeve paraprake, ka papajtueshmëri me gjyqtarin që merr pjesë në gjykimin e çështjes.

27. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se nuk ka papajtueshmëri, në kuptim të nenit 15 të KPP-së, për sa i përket faktit se i njëjti gjyqtar që ka shqyrtuar kërkesën e prokurorit për caktimin e masës së sigurimit personal ndaj të pandehurit, shqyrton edhe kërkesën e prokurorit, ose njërës prej palëve, për sigurimin e provës, sepse procedura e rregulluar nga neni 320 i KPP-së bën pjesë në kërkesat që mund të shqyrtohen nga i njëjti gjyqtar gjatë hetimeve paraprake. Papajtueshmëria qëndron në faktin se gjyqtari i hetimeve paraprake nuk mund të marrë pjesë në seancën për marrjen e provës, sepse kjo është pjesë e shqyrtimit gjyqësor të çështjes dhe nuk mund të kryhet nga gjyqtari i hetimeve paraprake.

28. Duke iu referuar rrethanave të çështjes konkrete, nga dosja gjyqësore rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, duke pretenduar se kanë lindur rrethana që bëjnë të domosdoshme sigurimin e provës, ka kërkuar të pranohet, që në fazën e hetimeve paraprake, pyetja e të dëmtuarës NC si dëshmitare. Bazuar në këtë kërkesë, gjyqtari AL ka bërë sigurimin si provë të dëshmisë së shtetases NC. Po ashtu, nga dosja gjyqësore rezulton se, mbi bazën e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, po ky gjyqtar ka dhënë vendimin për caktimin e masës së sigurimit arrest në burg ndaj të pandehurit Aurel Kote.

29. Duke qenë se gjyqtari AL ka marrë pjesë në procedurën për marrjen e provës, që rregullohet nga neni 321 i KPP-së, e cila është vlerësuar nga Gjykata se është pjesë e shqyrtimit gjyqësor, ai nuk mund të konsiderohej më si gjyqtar i hetimeve paraprake, pra nuk mundej më të shqyrtonte dhe të shprehej për asnjë kërkesë të prokurorit gjatë hetimeve paraprake, në kuptim të nenit 15/2 të KPP-së.

30. Megjithatë, Gjykata vlerëson se ky pretendim i kërkuesit duhet shqyrtuar edhe në përputhje me parimet që u referohen provave, sipas të cilave vlerësimi, dobishmëria dhe rëndësia e tyre provuese në një çështje konkrete është si rregull, detyrë e gjykatave të sistemit gjyqësor, ndërsa verifikimi i ligjshmërisë së krijimit dhe marrjes së provave i nënshtrohet edhe kontrollit të Gjykatës, pasi ky aspekt i gjykimit ka lidhje të drejtpërdrejtë me procesin e rregullt ligjor (*shih vendimin nr.1, datë 12.1.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Gjykata ka vlerësuar se marrja e provave në mënyrë të ligjshme përbën një aspekt të rëndësishëm të respektimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Në këtë drejtim detyra e Gjykatës është të vlerësojë nëse procesi si i tërë, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave, ka qenë i drejtë. Në qëndrimet e arsyetimet e veta Gjykata, ndërsa ka pranuar se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt në kuptimin kushtetues, ka pranuar, gjithashtu, se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit (*shih vendimin nr.21, datë 1.10.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim, Gjykata ka theksuar se nuk është detyrë e saj të përcaktojë rëndësinë vendimtare të një prove, si dhe evidentimin e pavlefshmërisë së një dëshmie të marrë gjatë hetimeve paraprake, për sa kohë që gjykatat e zakonshme, në arsyetimin e vendimeve të tyre, e mbështesin fajësinë e kërkuesit edhe mbi disa prova të tjera (*shih vendimet nr.9, datë 28.4.2004 dhe nr.42, datë 18.12.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Duke iu rikthyer çështjes konkrete në shqyrtim, Gjykata vëren se gjatë gjykimit të çështjes penale në ngarkim të kërkuesit, edhe pse kjo çështje është gjykuar dhe rigjykuar disa herë nga gjykatat, prova thelbësore mbi të cilën janë bazuar ato për dhënien e vendimit të fajësisë, është pikërisht dëshmia e shtetases NC, e siguruar si provë me vendimin, datë 11.11.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Nga vendimet e gjykatave rezulton, gjithashtu, se të vetmet prova të tjera të administruara nga gjykatat janë deklaratimet e disa dëshmitarëve (familjarë të së dëmtuarës), të cilat kanë si burim vetëm deklaratimet e të dëmtuarës NC, si dhe disa prova shkresore të dërgimit të parave me “Western Union” (nga e dëmtuara për kërkuesin). Nga dosja gjyqësore rezulton, gjithashtu, se në gjykimin në gjykatën e apelit, prokurorja e çështjes ka kërkuar të thirret si dëshmitare e dëmtuara NC. Në seancën e datës 30.09.2004, kjo shtetase është paraqitur para gjykatës, ku ka deklaruar se ajo nuk kishte ushtruar asnjëherë prostitucion në Itali dhe se kallëzimin për kërkuesin e kishte bërë në kushtet e një gjendjeje jo të mirë mendore, për arsye se ai nuk pranonte të njihte atësinë e fëmijës së tyre dhe duke menduar se ky kallëzim do ta detyronte të bënte një gjë të tillë. Kjo dëshmitare ka deklaruar, gjithashtu, se e kishte tërhequr kallëzimin dhe se bashkëjetonte me kërkuesin, i cili kishte njohur atësinë e fëmijës së tyre, dhe se bashkë kishin marrëdhënie të mira (fq.23 e dosjes gjyqësore).

33. Gjykata vëren se vendimet e gjykatave, që e kanë deklaruar fajtor kërkuesin, kanë si burim vetëm deklaratimet e shtetases NC të dhëna në seancën për sigurimin e provës (dëshmisë). Edhe pse kjo dëshmitare ka ndryshuar dëshminë e saj para gjykatës, kjo e fundit nuk ka ndërmarrë asnjë veprim tjetër për të verifikuar vërtetësinë ose jo të deklaratimeve të kësaj shtetaseje. Për sa më sipër, duke qenë se deklaratimet e shtetases NC, të marra në seancën për sigurimin e dëshmisë, janë prova e vetme mbi të cilën gjykatat kanë mbështetur fajësinë e kërkuesit, mosrespektimi nga ana e gjykatës, gjatë procedurës për sigurimin e kësaj prove, të ndalimeve të parashikuara nga neni 15/2 i KPP-së, e bën këtë provë të marrë në mënyrë të paligjshme dhe, në këto kushte, edhe procesin gjyqësor të parregullt nga pikëpamja kushtetuese.

C. Në lidhje me pretendimin e kërkuesit se nuk i është siguruar një mbrojtje efektive

34. Kërkuesi pretendon se atij nuk i është siguruar një mbrojtje efektive dhe reale, për arsye se gjatë gjithë procesit janë angazhuar 6 avokatë, të cilët kanë zvarritur çështjen, nuk kanë bërë parashtesa përpara gjykatës, nuk kanë kundërshtuar provat e kërkuara nga prokurori, nuk kanë kërkuar marrjen e provave në favor të kërkuesit, kanë hequr dorë nga pyetja e dëshmitarëve, nuk kanë bërë kundërrekurs dhe nuk kanë marrë pjesë në dy gjykime të zhvilluara në Gjykatën e Lartë.

35. Gjykata ka pranuar si tregues thelbësor të një procesi të rregullt penal, ekzistencën e mbrojtjes. Realizimi i së drejtës së mbrojtjes përfshin jo vetëm të drejtën për të pasur një avokat, por dhe realizimin e një mbrojtjeje të kualifikuar dhe efektive (*shih vendimin nr.7, datë 12.3.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Që e drejta e mbrojtjes të jetë reale dhe efektive dhe jo vetëm teorike, Gjykata ka theksuar se ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet por, përkundrazi, gjykata duhet të marrë të gjitha masat ligjore që, në funksion të procesit të drejtë, jo vetëm të sigurojë praninë e mbrojtësit në gjykim, por dhe t'i japë atij mundësinë të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar barazinë e armëve (*shih vendimet nr.30, datë 26.11.2009 dhe nr.37, datë 24.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Gjykata vëren se, me qëllim të sigurimit të një mbrojtjeje efektive, avokatët luajnë një rol kyç, për të siguruar që parimet e gjykimit të drejtë të respektohen. E drejta e mbrojtjes merr një rëndësi të veçantë, sidomos në procesin penal. Kështu, gjatë këtij procesi kushdo ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi të zgjedhur prej tij dhe, në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas. Interesat e drejtësisë kërkojnë detyrimisht realizimin e mbrojtjes, qoftë edhe me avokat të caktuar kryesisht (*shih vendimin nr.30, datë 26.11.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

38. GJEDNJ-ja është shprehur se, për shkak të pavarësisë së organizimit të profesionit të avokatit “dhënia/mënyra e mbrojtjes është thelbësisht një çështje ndërmjet të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, qoftë ai i zgjedhur vetë apo i caktuar kryesisht”. Përgjegjësia e Shtetit do të pranohet nëse gjykatat e brendshme nuk ndërhyjnë kur ka pasur një “dështim të dukshëm” për të siguruar një mbrojtje efektive ose kur një gjë e tillë “është sjellë në vëmendjen e tyre mjaftueshmërisht në ndonjë mënyrë tjetër” (*shih vendimet e GJEDNJ-së në çështjet: Kamasinski v. Austria, datë 19 dhjetor 1989, § 65; Rutkowski v. Poland, datë 19 tetor 2000; Alvarez Sanchez v. Spain, datë 23 tetor 2001*).

39. Për këtë qëllim, duhen shqyrtuar rast pas rasti rrethanat e çështjes, si për shembull veprimet që ka ndërmarrë mbrojtësi (nëse ka marrë pjesë në fazën e hetimeve paraprake, ka qenë i pranishëm në seancat gjyqësore, ka paraqitur parashtrime me shkrim, ka pyetur dëshmitarë, ka kërkuar marrjen e provave etj.), fakti se në cilën fazë të procesit ka ndodhur shkelja e pretenduar dhe sa e rëndësishme ishte ajo për të pandehurin dhe rezultatin e gjithë procesit gjyqësor, fakti nëse gjykatat mund të kishin marrë masa për të parandaluar shkeljen në fjalë, fakti nëse shkeljet e pretenduara u ngritën para gjykatës etj.

40. Nga dosja gjyqësore rezulton se procesi gjyqësor, në të gjitha shkallët e gjykimit, është zhvilluar në mungesë të kërkuarit Aurel Kota dhe ky i fundit rezulton të jetë përfaqësuar, gjatë gjithë procesit, nga disa mbrojtës, ku disa kanë qenë të zgjedhur prej tij me prokurë dhe në disa raste edhe të caktuar kryesisht nga gjykata. Mbrojtësit e të pandehurit kanë qenë të pranishëm në seancat gjyqësore, kanë kundërshtuar provat dhe pretendimet e palës akuzuese, u kanë drejtuar pyetje dëshmitarëve, si dhe kanë kërkuar marrjen e provave në favor të kërkuarit. Po ashtu mbrojtësit kanë paraqitur si ankim kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë që ka vendosur fajësinë e kërkuarit, ashtu edhe rekurs kundër vendimit të gjykatës së apelit që la në fuqi vendimin e fajësisë.

Për sa më sipër, bazuar në rrethanat e çështjes konkrete, Gjykata nuk gjen argumente për të konkluduar se kjo mbrojtje nuk ka qenë efektive.

D. Në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës së mbrojtjes në Gjykatën e Lartë

41. Kërkuari pretendon se Gjykata e Lartë në dy gjykime, edhe pse e vënë në lëvizje nga prokuroria, ka zhvilluar seancat gjyqësore në mungesë të mbrojtësit të kërkuarit.

42. Gjykata ka vlerësuar se, përgjithësisht, seancat gjyqësore nuk mund të zhvillohen pa praninë e avokatit dhe se pjesëmarrja e të pandehurit në gjykim në Gjykatën e Lartë nuk është automatikisht e domosdoshme, me përjashtim të rasteve kur cilësitë personale të të pandehurit kanë rëndësi vendimtare për dhënien e drejtësisë, sepse debati zhvillohet për çështje të ligjit. Në rast se as avokati dhe as i pandehuri nuk paraqiten në seancë, është e palejueshme që ajo të vazhdojë, veçanërisht në rastin kur ajo vihet në lëvizje mbi bazën e rekursit të paraqitur nga prokurori, i cili mbart në potencë mundësinë e përkeqësimit të pozitës së të pandehurit. Presumimi se i pandehuri nuk ka marrë pjesë në gjykim me vetëdije, mund të justifikohet vetëm nëse atij i është bërë njoftimi personalisht dhe mund të vërtetohet që ai e ka marrë vetë atë (*shih vendimin nr.13, datë 21.7.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

43. Nga dosja gjyqësore rezulton se Gjykata e Lartë ka zhvilluar dy seanca gjyqësore në mungesë të kërkuarit dhe mbrojtësit të tij, konkretisht ato që i përkasin gjykimit të rekurseve të prokurorëve për vendimet e gjykatës së apelit që kanë pushuar çështjen penale në ngarkim të kërkuarit. Në përfundim të gjykimeve përkatëse rezulton se Gjykata e Lartë ka vendosur, në të dyja rastet, prishjen e vendimeve të gjykatës së apelit që kishin vendosur në favor të kërkuarit.

44. Siç dhe u theksua më sipër, Gjykata ka vlerësuar se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt në aspektin kushtetues dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një

proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit. Duke shkuar më tej, Gjykata nuk ka pranuar pretendimet për cenimin e parimeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor në rastet kur gjykata e shkallës më të lartë ka plotësuar apo korrigjuar mangësitë e gjykatave të shkallëve më të ulëta në plotësimin e standardeve dhe elementeve të një procesi të rregullt ligjor (*shih vendimin nr.21, datë 1.10.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

45. Gjykata vëren se në gjykimet e kundërshtuara nga kërkuesi, të zhvilluara në Gjykatën e Lartë, në të dyja rastet kjo e fundit ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe kthimin e akteve po asaj gjykate për rigjykimin e çështjes. Pas disa rigjykimesh, çështja është shqyrtuar përsëri nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbi bazën e rekursit të paraqitur nga mbrojtësi i kërkuesit dhe, përfundimisht, në lidhje me këtë proces Gjykata e Lartë ka dhënë vendimin nr.184, datë 3.3.2010, i kundërshtuar në Gjykatën Kushtetuese nga kërkuesi. Nga aktet e dosjes gjyqësore rezulton se në këtë gjykim, të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, mbrojtësi i kërkuesit ka qenë i pranishëm dhe ai është dëgjuar nga ajo gjykatë.

46. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë ka plotësuar/korrigjuar mangësitë e proceseve të mëparshme të zhvilluara prej saj, duke respektuar në këtë mënyrë standardet e një procesi të rregullt ligjor. Në këto kushte, pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së mbrojtjes në Gjykatën e Lartë është i pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131 shkronja “f” dhe nenit 134 pika 1 shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 dhe 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr.101, datë 7.4.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, vendimit nr.117, datë 26.10.2007 të Gjykatës së Apelit Korçë dhe vendimit nr.184, datë 3.3.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë Korçë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Sokol Sadushi, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj, Sokol Berberi, Admir Thanza

Anëtarë kundër: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Petrit Pllloçi

MENDIM PAKICE

Nuk pajtohem me qëndrimin e shumicës, si për legjitimitimin e kërkuesit, ashtu edhe për pretendimet për proces të parregullt ligjor.

1. Lidhur me legjitimitimin e kërkuesit

Jemi të mendimit se kërkuesi nuk legjitimohet në kërkimet e tij para kësaj Gjykate, pasi ai nuk ka shteruar mjetet juridike, si kusht për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese. Shterimi i mjeteve nënkupton se ankuesi duhet të shfrytëzojë të gjitha mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete¹. Individit para se t’i drejtohet kësaj Gjykate duhet jo vetëm të ketë shfrytëzuar nga pikëpamja formale mjetet juridike të njohura nga legjislativi në fuqi, pra t’i jetë drejtuar të gjitha instancave administrative dhe gjyqësore të parashikuara për këtë qëllim, por t’i ketë ezauruar ato edhe nga pikëpamja thelbësore d.m.th. t’i ketë parashtruar

¹ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.27/2007

pretendimet e tij realisht para çdo instance. Një gjë e tillë nuk rezulton të jetë bërë nga kërkuesi.

Nga dosja gjyqësore, si dhe nga deklaratimet e përfaqësuesit të kërkuesit në seancë rezulton se kërkuesi ose mbrojtësit e tij nuk i kanë paraqitur pretendimet për paanshmëri të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, as gjatë gjykimit në shkallë të parë, as në gjykimin në gjykatën e apelit. Ankimi kushtetues individual për një proces të rregullt ligjor është një mjet subsidiar, pra plotësues krahas mjeteve të zakonshme gjyqësore. Ky është tashmë një qëndrim i konsoliduar i Gjykatës Kushtetuese, i cili ka theksuar se *“pretendimi i kërkuesit se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë ka cenuar një element thelbësor kushtetues që lidhet me gjykatën kompetente, pasi e ka gjykuar çështjen me një gjyqtar pa përcaktuar më parë vlerën e padisë, nuk mund të merret në shqyrtim në aspektin e kontrollit kushtetues sepse nuk është ngritur në asnjë shkallë të gjykimit. Nga aktet nuk rezulton që palët e interesuara në gjykim ta kenë ngritur një pretendim të tillë në gjykatën e shkallës së parë dhe as në atë të apelit. Në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, përmendet fakti që gjykimi është bërë nga një gjyqtar, por nuk është kërkuar që çështja të gjykohet me trup gjykues duke përcaktuar edhe vlerën e padisë. Lidhur me këtë, Gjykata Kushtetuese konfirmon qëndrimin e saj të mbajtur në vendimet e mëparshme se shkelja e të drejtave kushtetuese për një proces të rregullt ligjor mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pas shterimit të të gjitha mundësive që ofron sistemi i padive dhe i apelimeve.² Mbrojtja kushtetuese për një proces të rregullt ligjor nënkupton edhe konsumimin, si rregull, para gjykatave të sistemit gjyqësor të çdo pretendimi ligjor që parashikohet si shkak shfuqizimi në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese. Prandaj, ky pretendim mbi përbërjen e trupit gjykues, i ngritur nga kërkuesi në Gjykatën Kushtetuese, nuk mund të shërbejë si shkak për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore”.*³

Për sa më lart, në bazë të jurisprudencës së konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese, mendojmë se kjo Gjykatë nuk duhej të kishte marrë në shqyrtim kërkesën për arsye të moslegjitimit të kërkuesit.

2. Lidhur me pretendimin për paanshmërinë e gjykatës

Sa i takon pretendimit të kërkuesit se është cenuar parimi i paanshmërisë së gjykatës, pasi gjyqtari që ka marrë pjesë në sigurimin e provës ka vendosur edhe për masën e sigurimit ndaj kërkuesit, mendojmë se ai është i pabazuar. Paanshmëria e gjykatës është një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, të cilin Gjykata Kushtetuese e ka trajtuar gjerësisht në jurisprudencën e saj, duke vlerësuar se *“parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e vet subjektiv, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin objektiv me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimit prej saj të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim ... Në shtetin e së drejtës, kjo kërkesë merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë që duhet të krijojnë në çdo rast në shoqërinë demokratike, jo vetëm palët në gjykim, por çdo qytetar i thjeshtë.”*⁴

Duke u ndalur specifikisht te testi objektiv i paanshmërisë, Gjykata ka deklaruar se *“kur shqyrtohet nëse në një çështje të caktuar ekziston një arsye e ligjshme për të dyshuar se një gjyqtar nuk është i paanshëm, këndvështrimi i atyre që paraqesin këtë pretendim ka rëndësi, por vendimtar mbetet përcaktimi nëse ky dyshim është objektivisht i justifikueshëm”.*⁵

Duke iu referuar çështjes konkrete, rezulton se gjyqtari ka shqyrtuar kërkesën për sigurimin e provës, si dhe ka vendosur masën e sigurimit për të pandehurin (kërkuesin). Pakica vlerëson se seanca që zhvillohet për sigurimin e provës ka për qëllim marrjen e një prove para fillimit të shqyrtimit gjyqësor, kur ka të dhëna se marrja e saj në një kohë të mëvonshme do të ishte e pamundur ose jo e plotë për shkak se mund të zhdukej ose prishej. Pra, vendimmarrja e gjykatës në këtë rast ka të bëjë vetëm me sigurimin e një prove, e cila çmohet si e rëndësishme për procesin, por pa e vlerësuar atë në themel sa i takon rëndësisë dhe efektit që do të ketë në proces. Vlerësimi i provave bëhet vetëm në seancën gjyqësore që zhvillohet për themelin e çështjes. Asnjë provë nuk ka

² Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.10/2003.

³ Vendime të Gjykatës Kushtetuese nr.9/2005; nr.1/2006.

⁴ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.16/2003.

⁵ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.10/2009.

vlerë të paracaktuar dhe si e tillë i nënshtrohet shqyrtimit në themel. Në këtë kuptim, gjykata ka të drejtë të marrë çdo provë të parashikuar me ligj, ndërsa vlerën asaj ia jep vetëm gjatë hetimit gjyqësor dhe pasi ka dëgjuar të gjitha palët pjesëmarrëse. Për këtë arsye, pjesëmarrja e gjyqtarit në procesin e sigurimit të provës dhe në atë të sigurimit personal të të pandehurit nuk mund të konsiderohet si cenim i paanshmërisë, pasi sigurimi i provës nuk është pjesë e hetimit gjyqësor në themel por e hetimit paraprak dhe gjyqtari në këtë rast nuk bën vlerësimin e provës, por vetëm çmon nevojën e marrjes së saj para fillimit të shqyrtimit gjyqësor, me qëllim parandalimin e zhdukjes ose prishjes së provës. Në këto kushte, nuk ndodhemi para ndalimit të nenit 15/2 të KPP-së. Përveç kësaj, të kundërshtosh mënyrën e sigurimit të provës pas një periudhe kohore disavjeçare (prej 8 vitesh) e bën të pakuptimtë vetë rolin dhe rëndësinë e këtij instituti të veçantë të së drejtës procedurale penale, kur në vetvete ky mjet procedural është i jashtëzakonshëm dhe gjen zbatim vetëm në raste emergjence.

Për këtë arsye, nuk pajtohemi me qëndrimin e shumicës, që e konsideron si papajtueshmëri faktin e pjesëmarrjes së gjyqtarit në seancën e sigurimit të provës dhe atë të vendosjes së masës së sigurimit personal të të pandehurit dhe si rrjedhojë nuk mendon se ka të bëjë me cenim të procesit të rregullt ligjor.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Petrit Plloçi, Xhezair Zaganjori.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 3.10.2011
Doli nga shtypi më 3.10.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 36 lekë